

Projekti: “Ndërtimi i kapaciteteve për zhvillim të qëndrueshëm të kapitalit në Maqedoninë e Veriut”

Fusha e Aktivitetit IV - Zhvillimi dhe realizimi i aktiviteteve për ngritje të kapaciteteve për ndryshimet klimatike dhe punës e politikës sociale

Udhëzues për përmirësimin e aspekteve të ndryshimeve klimatike në projektet e zhvillimit social

Eksperte kombëtare
Suzana Ignjatovikj Aleksova

Eksperte ndërkombëtare
Magdalena Hoerst

janar 2024

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtesave	3
1. Hyrje.....	4
1.1. Historia dhe arsyetimi	7
1.2. Objektivat e Udhëzuesit.....	8
1.3. Fushëveprimi dhe struktura.....	8
2. Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimi Social.....	9
2.1. Diskursi aktual mbi Zhvillimin Social dhe Ndryshimet Klimatike.....	10
2.2. Lidhjet ndërmjet Ndryshimeve Klimatike dhe Zhvillimit Social	11
2.3. Sfidat kryesore të ndryshimeve klimatike për projektet e zhvillimit social	13
3. Integrimi i Ndryshimeve Klimatike në Projektet e Zhvillimit Social	17
3.1. Parimet për projekte të zhvillimit social të përgjegjshëm ndaj klimës	17
3.2. Bashkëpunimi me palët e interesuara.....	22
3.3. Mangësitë dhe sfidat në lidhjen e ndryshimeve klimatike me projektet e zhvillimit social	23
4. Udhëzues hap pas hapi për integrimin e ndryshimeve klimatike në projektet e zhvillimit social	25
4.1. Identifikimi i rreziqeve lidhur me klimën (vlerësimi i rrezikut të klimës)	26
4.2. Identifikimi i dobësive.....	27
4.3. Veçoritë dhe opsionet e projekteve të zhvillimit social të përgjegjshëm ndaj klimës.....	29
4.4. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi	30
5. Përfundim.....	30
Shtojca A: Shembuj të programeve të Mbrojtjes Sociale që integrojnë menaxhimin e rrezikut klimatik	32

Lista e shkurtesave

ANK	Adaptimi ndaj Ndryshimeve Klimatike
EQLKAQ	Evropa Qendrore dhe Lindore, Kaukazi dhe Azia Qendrore
RRF	Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë
KRrPK	Kontributet e Rritura të Përcaktuara Kombëtare
FGJK	Fondi i Gjelbër i Klimës
GS	Gazrat Serra
PNNK	Panel Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
PKA	Plane Kombëtare të Adaptimit
KPK	Kontributet e Përcaktuara Kombëtare
OJQ	Organizata Joqeveritare
KKS	Komiteti Këshillimor Strategjik
PS	Politika Sociale
SPL	Mbrojtja Sociale dhe Puna

1. Hyrje

Sipas parashikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, temperaturat mesatare vjetore do të rriten deri në vitin 2050 dhe më tej, duke sjellë efekte negative për të gjithë sektorët ¹. Maqedonia e Veriut do të ketë një klimë më të nxehtë dhe më të thatë, me rritje të temperaturave ekstreme të larta dhe ulje të temperaturave ekstreme të ulëta. Pavarësisht parashikimeve për kushte më të thata, pritet një rritje e ngjarjeve ekstreme me reshje, duke rezultuar me rritje të rrezikut për përmbytje të shpejta. Në periudhën e verës, numri i ditëve të thata të njëpasnjëshme ka gjasa të rritet, duke çuar në thatësira më të shpeshta. Sezoni i rritjes gjithashtu pritet të zhvendoset dhe të zgjatet. Hulumtimet aktuale sugjerojnë se këto ekstreme klimatike duke përfshirë thatësitat, përmbytjet dhe valët e të nxehtëit do të rriten në frekuencë dhe madhësi në të ardhmen.

Akoma më alarmante është se efektet e ndryshimeve klimatike janë regjistruar tashmë në Maqedoninë e Veriut:

- Rritjet e temperaturës mesatare vjetore në krahasim me periudhën 1961-1990 luhaten nga 0,2°C deri në 0,5°C.
- Ndër dhjetë vitet më të ngrohta të periudhës 1951-2012, janë pesë nga gjashtë vitet e fundit (2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2012).
- Monitorimet e reshjeve kanë treguar një tendencë të përgjithshme të uljes së tyre.
- Frekuenca më e madhe e valëve të të nxehtëit ka ndodhur në dhjetë vitet e fundit, me paraqitje maksimale në numrin më të madh të stacioneve në vitin 2012 dhe vitin 2007.²

Qeveria e Maqedonisë së Veriut njih problemet dhe dëshiron të veprojë, dhe vendimmarrja duhet të kombinojë përfshirjen e grupeve të marginalizuara dhe të cenueshme. Ndryshimet klimatike konsiderohen kryesisht një sfidë për infrastrukturën lokale, furnizimet me energji, bujqësinë, pylltarinë dhe sektorë të tjerë ekonomikë – rrallë si një sfidë sociale. Edhe pse ndikimet në shëndetësi janë ndoshta çështja kryesore sociale e debatuar në lidhje me politikën klimatike, këto ndikime madje janë analizuar shumë pak në kontekstin e Maqedonisë së Veriut dhe për këtë shkak mungojnë politika adekuate të mjaftueshme. Shumë sfida të tjera sociale si varfëria dhe mirëqenia, migrimi i shkaktuar nga ndryshimet klimatike, rritja e pabarazisë gjinore të shkaktuar nga ekstremet e motit, ndikimet në jetëgjatësinë dhe cilësinë e jetës, si dhe ndikimet mjedisore, arsimore dhe kulturore, kanë tendencë të anashkalojnë gjatë zbatimit aktiv të politikave. Disa autoritete kombëtare të politikës klimatike rrallëherë i përfshijnë organet qeveritare përgjegjëse për politikën sociale, e interesat sociale dhe nevojat specifike të grupeve të cenueshme shpesh mungojnë. Nuk ekziston bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet mekanizmave gjinorë dhe sektorëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike (mjedisi, planifikimi hapësinor, etj.) në fushën e bërjes së politikave për ndryshimet klimatike. Koordinatorët për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat në Organet e administratës publike nuk kanë njohuri dhe as nuk janë të informuar me tekstin e planit të veprimit për gjininë dhe ndryshimet klimatike, as nuk janë të njohur me varësinë nga cenueshmëria e bazuar në gjini ndaj ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike (në çfarë mënyre

¹ Raporti Special i IPCC mbi ngrohjen globale prej 1.5°C - miratuar zyrtarisht nga qeveritë e botës në 2018

² Komunikimi i Katërt Kombëtar për Ndryshimet Klimatike, <https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/15644574e26d61>



dhe a lidhet gjinia me kapacitetet zbutëse dhe përshtatëse), megjithëse disa kanë marrë pjesë në seminare për krijimin e politikave për ndryshimet klimatike.

Ata nuk kanë informacion nëse burrat dhe gratë kanë qasje të barabartë në burimet/shërbimet e zbutjes dhe përshtatjes dhe nëse ndryshimi i klimës po rrit pabarazitë dhe cenueshmërinë ekzistuese gjinore. Gjithashtu, koordinatorët nuk kanë njohuri për arsyet e pozicioneve të ndryshme të grave dhe burrave në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.³

Është evidente mungesa e mbështetjes teknike në kryerjen e Vlerësimeve Mjedisore dhe Sociale dhe zhvillimin projekt-propozimeve të Planeve të Veprimit Gjinator. Pavarësisht se kjo temë ka filluar të trajtohet në shumë projekte dhe programe, veçanërisht të financuara nga programet zhvillimore shumëpalëshe, mbështetja që ekziston në treg ende është kryesisht e lidhur me programet specifike të financimit të donatorëve dhe bazohet në kërkesat specifike të donatorëve.⁴

Qëllimi kryesor është mbrojtja e qytetarëve nga dëmet dhe humbjet e shkaktuara tashmë nga ndryshimet klimatike, si dhe nga kërcënimet dhe fatkeqësitë. Deri më tani, shumë ndërhyrje për përshtatjen dhe zbutjen ndaj ndryshimeve klimatike⁵ janë përqendruar në rolin e sektorëve të veçantë - si energjia, komunikimet ose uji - dhe në projekte për infrastrukturë rezistente ndaj klimës. Për shembull, bëhen shumë kërkime në sektorin bujqësor se si të modifikohen të korrat në kontekstin e ndryshimeve klimatike dhe si të kalohet në teknologjitë me emetim të papërfillshëm. Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet çështjeve sociale, siç janë rreziqet indirekte, prekshmëria e familjeve, menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë dhe përfshirja e njerëzve të varfër dhe të cenueshëm. Ekziston nevoja për një përgjigje të fortë të politikave sociale, me kuptimin e rreziqeve që lidhen me ndryshimin e klimës dhe cenueshmërinë klimatike me të cilat përballen skamnorët. Gjithashtu ekziston një rol i politikës sociale që ka të bëjë me fuqizimin e të varfërve dhe për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë zërin dhe asetet politike të nevojshme për të kërkuar qasje në instrumentet e menaxhimit të rrezikut klimatik. Prandaj, mbrojtja sociale duhet parë si sektor vendimtar për përshtatje dhe zbutje në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Mund të krijohet një sinergji midis qasjes të politikave sociale ndaj përshtatjes së veprimit klimatik dhe zbutjes së varfërisë. Çelësi është në të kuptuarin e rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike dhe cenueshmërinë klimatike me të cilat përballen njerëzit e varfër dhe të cenueshëm, dhe ndërtimi i instrumenteve që i ndihmojnë njerëzit të menaxhojnë këto rreziqe.

Pavarësisht problemit të përsëritur të trajtimit të goditjeve klimatike dhe zbutjes së tyre, mbulimi nga programet dhe instrument që ndihmojnë njerëzit e varfër dhe të cenueshëm të menaxhojnë rreziqet klimatike mbetet shumë i ulët; përshtatjet në mbështetje të skamnorëve duhet të synojë ndryshimin e kësaj situate. Në përgjithësi, ekzistojnë disa vegla për përmbushjen e nevojave të grupeve të cenueshme, si p.sh. futja e fondeve të fokusuara sociale në rrjetet për siguri sociale për fatkeqësitë natyrore, mjetet e jetesës, mikro-financat dhe sigurimet. Gjithashtu, çdo masë efektive zbutëse do të jetë në dobi të të gjithë shoqërisë, përfshirë edhe grupet e cenueshme.

³ Burimi: <https://api.klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/07015e39ea890385>

⁴ Burimi: <https://www.greenclimate.fund/sites/default/files/document/mkd004.pdf>

⁵ Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike është procesi i përshtatjes me klimën aktuale ose të pritshme dhe efektet e saj. Ndërsa zbutja përfshin veprime që ulin shkallën e ndryshimeve klimatike. Zbutja e ndryshimeve klimatike arrihet duke kufizuar ose parandaluar emetimet e gazrave serrë dhe duke rritur aktivitetet që largojnë këto gazra nga atmosfera.

Fondi i Gjelbër i Klimës (FGJK) vepron ndaj pabarazive të zmadhuara dhe të krijuara nga ndryshimet klimatike për komunitetet e cenueshme dhe pranon faktin se ndryshimet klimatike prekin në mënyrë jo proporcionale grupet e cenueshme, duke përfshirë të varfrit, të moshuarit dhe ata me qasje të kufizuar në resurse. Këto grupe janë më pak të afta për t'u përgatitur, për t'u përgjigjur dhe për t'u rikuperuar nga fatkeqësitë e lidhura me klimën. Gjithashtu, gratë shpesh përballen me sfida më të mëdha në kontekstin e ndryshimeve klimatike për shkak të faktorëve socialë, ekonomikë dhe kulturorë. Ato mund të kenë qasje të kufizuar në burime, në pushtetin vendimmarrës dhe përballen me rreziqe më të larta gjatë fatkeqësive të lidhura me klimën. Duke marrë parasysh këtë grup sfidash komplekse, FGJK është aktive në fushat e mëposhtme:

- FGJK mbështet projekte që formojnë qëndrueshmëri në komunitetet me prirje për migrim të shkaktuar nga klima. Kjo përfshin investime në bujqësi të qëndrueshme, menaxhimin e ujit dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm për të reduktuar nevojën për migrim si një mekanizëm përballues.
- FGJK i jep prioritet projekteve që adresojnë nevojat e popullatave të cenueshme. Kjo përfshin financim të iniciativave për përshtatje me bazë në komunitet, programet e ndërtimit të kapaciteteve dhe zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse që sigurojnë qasje të barabartë në burime dhe shërbime. FGJK promovon qasje të përgjegjshme gjinore në projektet të financuara. Kjo përfshin sigurimin e pjesëmarrjes së grave në planifikimin dhe zbatimin e projekteve, duke synuar dobësitë specifike të grave dhe mbështetjen e iniciativave që fuqizojnë gratë si agjente të ndryshimit në veprimin klimatik.

Këto Udhëzime janë zhvilluar për shkak të nevojës për të krijuar sinergji midis veprimit klimatik dhe politikës sociale. Duke kuptuar rreziqet me të cilat përballen njerëzit e varfër dhe të cenueshëm, strategjitë e përshtatjes dhe projektet e politikave sociale mund të hartohen për të dyja – (1) adresimin e ndikimeve klimatike dhe (2) kontributin në zhvillimin social. Qëllimi mund të jetë zgjerimi i mbulimit të programeve që ndihmojnë njerëzit e varfër dhe të cenueshëm të menaxhojnë rreziqet klimatike. Kjo mund të përfshijë zgjerimin e rrjeteve të sigurisë sociale për fatkeqësitë natyrore dhe të sigurojë që përpjekjet për përshtatje të jenë gjithëpërfshirëse dhe të barabarta.

Trajtimi i migracionit, cenueshmërisë sociale dhe çështjeve gjinore është thelbësor për përshtatje efektive ndaj ndryshimeve klimatike. Prioritetet e financimit të FGJK pasqyrojnë nevojën për të integruar këto vlerësime në projektet e zbutjes dhe përshtatjes për të siguruar që ato të jenë gjithëpërfshirëse, të barabarta dhe të përgjegjshme ndaj nevojave të popullatave më të cenueshme. Plani Strategjik për 2024-2027 artikulon se si FGJK do të rrisë ndjeshëm mbështetjen e saj për vendet në zhvillim, do të përmirësojë qasjen dhe do të përpikjet të japë nivelet më të larta të ndikimit katalitik përmes aseteve të saj kryesore - burimet financiare, partneritetet, fuqia e mbledhjes, njerëzit dhe njohuritë. Propozimet duhet të plotësojnë gjashtë kriteret e FGJK për investim, e që janë potenciali i ndikimit, potenciali i ndryshimit të paradigmës, potenciali i zhvillimit të qëndrueshëm, nevojat e marrësit, pronësia e vendit dhe efikasiteti dhe efektiviteti.

1.1. Historia dhe arsytimi

Dëshmitë, siç paraqiten në raportet e rregullta të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (PNNK) dhe hulumtime të tjera⁶, tregojnë se disa nga efektet më negative të ndryshimeve klimatike do të jenë në vendet në zhvillim, ku popullatat janë më të cenueshme dhe me më pak gjasa të përshtaten lehtësisht ndaj ndryshimeve klimatike, dhe se ndryshimi i klimës do të ndikojë në potencialin për zhvillim në këto vende. Prandaj, projektet dhe iniciativat e politikave sociale do të duhet të marrin parasysh këto kushte dhe ndikime të ndryshueshme për grupet e cenueshme.

Zhvillimi social synon të lehtësojë realizimin e potencialit të plotë të çdo anëtari të një shoqërie duke rritur standardin e tyre të jetesës. Suksesi i një shoqërie është i lidhur me mirëqenien e çdo qytetari. Zhvillimi social do të thotë të investosh te njerëzit. Ndryshimet klimatike kanë pasoja të rënda për njerëzit dhe mjedisin, veçanërisht në vendet në zhvillim. Politikat dhe projektet sociale paraqesin një mundësi për të zhvilluar strategji gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut për të adresuar humbjet dhe dëmet nga ndryshimet klimatike. Zhvillimi i politikave sociale të përgjegjshme ndaj klimës merr parasysh një spektër të gjerë çështjesh, duke përfshirë urbanizimin dhe migrimin, ndikimin e politikave të gjelbra tek të varfrit, qasjen në kujdesin bazik shëndetësor dhe rreziqet për grupet e marginalizuara shoqërore.

Tashmë ekzistojnë disa sinergji midis politikave të ndryshimeve klimatike dhe agjendave të zhvillimit të qëndrueshëm në vendet në zhvillim, si në fushat e efikasitetit të energjisë, energjisë së rinovueshme, transportit dhe politikave të qëndrueshme të përdorimit të tokës. Pavarësisht vëmendjes së kufizuar nga hartuesit e politikave deri më sot, politikat e ndryshimeve klimatike mund të kenë përfitime të rëndësishme plotësuese për mjedisin lokal. Edhe e kundërta është gjithashtu e vërtetë, pasi politikat lokale dhe kombëtare për të trajtuar mbingarkesën, cilësinë e ajrit, qasjen në shërbimet energjetike dhe në diversitetin e energjisë mund gjithashtu të kufizojnë emetimet e gazrave serrë (GS). Megjithatë, mund të ketë kompromise të rëndësishme që lidhen me nivele më ambicioze të zbutjes, për shembull kur vendet në zhvillim varen nga qymyri dhe mund t'u kërkohet të kalojnë në burime energjie më të pastra dhe më të shtrenjta për të limituar emetimet, siç është rasti i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ndikimet e shpërndarjes së politikave të tilla janë një përcaktues i rëndësishëm i fizibilitetit të tyre dhe duhet të merren parasysh paraprakisht.

Për më tepër, marrëveshjet e ardhshme për zbutjen dhe përshtatjen do të duhet të njohin situatat e ndryshme të vendit në lidhje me nivelin e zhvillimit të tij ekonomik, cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe aftësinë për përshtatje apo zbutje. Të kuptuarit se si ndryshimi klimatik ka të ngjarë të ndikojë në zhvillimin social mund të jetë hapi i parë drejt ndërtimit të strategjive me kosto efektive dhe kapaciteteve të integruara institucionale në vend për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike.

⁶ Varfëria dhe ndryshimet klimatike - Zvogëlimi i cenueshmërisë së të varfërve përmes adaptimit,
<https://documents1.worldbank.org/curated/en/534871468155709473/pdf/521760WP0pover1e0Box35554B01PUBLIC1>.

1.2. Objektivat e Udhëzuesit

Objektivi i këtij Udhëzuesi është të rrisë të kuptuarit nga ana e hartuesve të politikave dhe vendimmarrësve në lidhje me kryqëzimin midis dimensioneve sociale dhe përpjekjeve për zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike dhe për të rritur ndërgjegjësimin për zhvillimin social për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike. Udhëzuesi gjithashtu do të ofrojë udhëzim praktik se çfarë duhet marrë parasysh gjatë zhvillimit të projekteve në fushën e zhvillimit social, të cilat inkorporojnë ndryshimet klimatike. Udhëzuesi është zhvilluar posaçërisht për Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, megjithatë ai mund të jetë i rëndësishëm edhe për palë tjera të interesuara.

1.3. Fushëveprimi dhe struktura

Me këtë Udhëzues, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) si anëtare e Këshillit Kombëtar të Ndryshimeve Klimatike dhe Këshillit Kombëtar të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe me personin për kontakt të KKKBNK të emëruar për Gjininë dhe Ndryshimet Klimatike⁷; do të jetë në gjendje të përcaktojë masa të bazuara në informacione për promovimin e aktiviteteve për zhvillim të shoqërisë të zgjuara dhe gjithëpërfshirëse për klimën.

Aktualisht, në MPPS e kuptojnë gjithnjë e më shumë se shkak i ndryshimeve klimatike dhe ndikimi në rritje do të ketë kërkesë për mbrojtje sociale dhe do të kërkohet përshtatje e politikave ekzistuese të punës dhe sociale. Kjo mbështetet gjithashtu edhe në punën e fundit në MPPS, për shembull, punën e bërë për zhvillimin e treguesve gjinorë dhe të ndryshimeve klimatike⁸. Në kuadër të këtij dokumenti theksohet se masat në planet për barazi gjinore dhe masat në planet e ndryshimeve klimatike duhet të sinkronizohen në mënyrë që të ndërthurin gjininë dhe ndryshimet klimatike. Gjithashtu, rishikimi dhe përmirësimi i dokumenteve ekzistuese strategjike të barazisë gjinore mund të bëhet përmes krijimit të grupeve të punës ose organeve të tjera formale ndërinstitucionale (komisione, trupa punues) të përbërë nga përfaqësues nga të gjitha institucionet përkatëse, OSHC, akademja dhe sektori i biznesit në këtë fushë.

Nga ana tjetër, dokumentet ekzistuese strategjike që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike duhet të rishikohen për të përfshirë integrimin gjinor. Nuk është vërejtur asnjë bashkëpunim ndërinstitucional apo ndërinstitucional për lidhjen ndërmjet ndryshimeve klimatike dhe perspektivës gjinore, d.m.th. për këtë të fundit Koordinatorët për mundësi të barabarta më së shpeshti nuk janë përfshirë në aktivitete (punëtori, konsultime, grupe pune) dhe ata nuk konsultohen lidhur me perspektivën gjinore kur krijohen politikat për ndryshimet klimatike brenda institucioneve të tyre. Nuk ka të dhëna për përfshirjen e Grupit ndër-sektorial për mundësi të barabarta në proceset e krijimit të politikave për ndryshimet klimatike, ndërsa Komiteti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike në fushën e integritit gjinor, si shembull demonstroi Planin e Veprimit për çështje gjinore dhe ndryshime klimatike. Nga ana tjetër, anëtarët e KKNK-së konsiderojnë se ky komitet nuk është

⁷ Burimi: <http://unfccc.org.mk/>

⁸ Burimi: <https://mtsp.gov.mk/content/pdf/2021/8d47e610e8991b47f1377e>

funksional dhe se mbi të gjitha duhet të forcohet puna e tij, dhe më pastaj duhet të ndërmerren hapa për adresimin aktiv të çështjeve gjinore dhe ndryshimeve klimatike në punën e tij.⁹

Siç përmendet në Rekomandimet për forcimin e zbatimit të Propozim Planit të Veprimit për Çështje Gjinore dhe Ndryshime Klimatike, forcimi i kapaciteteve në nivelin administrativ dhe vendimmarrës të grupeve të interesit si për ndryshimet klimatike ashtu edhe për barazinë gjinore për ekzistencën e ndërthurjes gjinore me ndryshimet klimatike është një parakusht për zbatimin efektiv të KPK-së.

Ky udhëzues është i strukturuar në mënyrë që të përpunojë qëllimin dhe për të ngritur rolin e mundshëm të politikave sociale dhe të punës në adresimin e sfidave të shkaktuara nga ndryshimet klimatike për të mbështetur një tranzicion drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të tërhequr më shumë vëmendje.

Në këtë drejtim, Udhëzuesi ofron në kapitullin 2 një përmbledhje rreth kryqëzimit dhe mbivendosjeve të zhvillimit social. Ky seksion shtjellon diskursin aktual mbi zhvillimin social dhe ndryshimet klimatike, lidhjet midis sektorëve, si dhe sfidat kryesore për zhvillimin social lidhur me ndryshimin e klimës. Kapitulli 3 ofron njohuri se si çështjet e ndryshimeve klimatike mund të integrohen në zhvillimin social. Ai shtjellon më tej parimet për zhvillimin social të përgjegjshëm ndaj klimës, bashkëpunimin e palëve të interesuara, si dhe boshllëqet dhe sfidat e lidhjes së ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit social. Më tej, Kapitulli 4 paraqet një udhëzues praktik hap pas hapi se si të përfshihen çështjet e ndryshimeve klimatike në projektet e zhvillimit social. Kjo përfshin seksione mbi identifikimin e rreziqeve të lidhura me klimën, identifikimin e dobësive, një prezantim të veçorive të projektimit dhe opsioneve për zhvillim social të përgjegjshëm ndaj klimës dhe rekomandime për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve. Udhëzimet japin vërejtjet përmbys në Kapitullin 5 dhe një sërë shembujsh të programeve të zhvillimit social që inkorporon çështjet e ndryshimeve klimatike në Aneks.

2. Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimi Social

Mbrojtja sociale (MS) është një përzierje politikash dhe programesh që synojnë të reduktojnë varfërinë, cenueshmërinë dhe pabarazinë gjatë gjithë ciklit jetësor, dhe është zhvilluar në një thirrje për përshtatjen e sistemeve të mbrojtjes sociale ndaj sfidave të ndryshimeve globale si migrimi, ndryshimet klimatike dhe degradimi i mjedisit. Fokusi i masave të mbrojtjes sociale adreson nevojat dhe dobësitë më imediate, ndërsa zhvillimi social ndjek qëllime të ngjashme (përmirësimi i mirëqenies së individëve dhe komuniteteve) duke adresuar çështjet themelore strukturore dhe promovon zhvillimin e qëndrueshëm me masa afatgjata.

Në këtë Udhëzues të dy termat do të përdoren kryesisht si sinonime dhe janë të këmblyeshëm mes veti pasi lidhjet me temën e ndryshimeve klimatike janë të njëjta.

Lidhja midis zhvillimit social dhe ndryshimit klimatik shihet nga perspektiva se ndryshimi i klimës mund të dëmtojë ndërhyrjet në zhvillimin shoqëror, dhe për këtë arsye hartuesit e politikave dhe praktikuesit duhet që planet e tyre të veprimit dhe programet ti bëjnë rezistente ndaj klimës. Për

⁹ Burimi: <https://klimatskipromeni.mk/data/rest/file/download/4c85b126a2b6>

shembull, Strategjia e Bankës Botërore për Mbrojtjen Sociale dhe Punës (MSP) 2012–2022¹⁰ parashikon veprime për të mbrojtur personat e cenueshëm prej goditjeve klimatike dhe për të rritur kapacitetin e tyre adaptues, duke përfshirë sigurimin dhe diversifikimin e mjeteve të jetesës, ndër të tjera.

Planifikimi për mbrojtje sociale dhe zhvillimit të ndërgjegjshëm për klimën nënkupton përfshirjen e rrezikut dhe pasigurisë klimatike në vendimmarrje. Prandaj, projektet dhe strategjitë e mbrojtjes sociale duhet të kenë një fokus më të madh në fuqizimin e njerëzve të marginalizuar për t'u bërë agjentë aktivë në ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike. Për më tepër, për të arritur përfshirjen sociale, nevojiten më shumë kërkime mbi cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike të njerëzve të marginalizuar në aspektin social.

2.1. Diskursi aktual mbi Zhvillimin Social dhe Ndryshimet Klimatike

Adresimi i ndryshimeve klimatike në zhvillimin social krijon mundësi, pasi që ai rrit kapacitetet përshtatëse të komuniteteve dhe ndihmon në rritjen e objektivave të zhvillimit social. Në të njëjtën kohë, adresimi i aspekteve sociale do të mundësojë mobilizim drejt shtigjeve adekuate të qëndrueshme ndaj klimës.

Pavarësisht faktit se shoqëritë historikisht kanë demonstruar aftësitë për t'u përshtatur me rreziqet dhe ndryshimet klimatike, menaxhimi i luhatjeve klimatike ngel të jetë një qasje e shtrenjtë, e pamjaftueshme dhe joefektive për parandalimin e katastrofave humanitare – veçanërisht në dritën e parashikimeve aktuale të ndryshimeve klimatike (shih kapitullin 1). Republika e Maqedonisë së Veriut është e ndjeshme ndaj ndikimeve negative për shkak të cenueshmërisë së saj gjeografike, varësisë nga sektorët që janë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve klimatike, statusit të pafavorshëm ekonomik dhe kapacitetit të kufizuar për përshtatje.

Veçanërisht, mënyra se si t'i jepen përparësi investimeve, politikave dhe programeve për përshtatje dhe si të identifikohen barrierat në nivel vendi (politika, njohuria, teknologjia) ndaj përshtatjes efektive nuk janë kuptuar mirë. Madje, edhe më pak është kuptuar se si të sinkronizohen veprimet klimatike me objektiva të tjerë socialë, si barazia gjinore, ulja e varfërisë dhe fuqizimi. E gjithë kjo nxit studime fundamentale në lidhje me konceptimin e cenueshmërisë dhe funksionin e duhur të politikës sociale në zbutjen e pasojave të ndryshimeve klimatike për popullatat e cenueshme.

¹⁰ Burimi: <https://www.worldbank.org/en/topic/socialprotection/publication/social-protection-labor-strategy-2012-2022>

Mbrojtja sociale e përgjegjshme ndaj klimës mund të funksionojë si **parandalim ex-ante kundër goditjeve** (p.sh. programet e sigurimeve shoqërore dhe diversifikimit të rrezikut), **mbrojtje ex-post kundër fatkeqësive dhe ndryshueshmërisë klimatike** (p.sh. asistenca dhe shërbimet sociale dhe programet e punëve publike). Programet e zhvillimit social mund të **nxisin kapacitetin adaptues afatgjatë** (p.sh. nëpërmjet promovimit dhe diversifikimit të mjeteve të jetesës).

2.2. Lidhjet ndërmjet Ndryshimeve Klimatike dhe Zhvillimit Social

Në Maqedoninë e Veriut, varfëria dhe përfshirja sociale ndikohen veçanërisht nga ndryshimet klimatike për shkak të rritjes së paqëndrueshmërisë së klimës dhe ndikimeve afatgjata në jetesën dhe ekosistemet. Për shembull, familjet që varen nga bujqësia, blegtoria dhe pylltaria janë veçanërisht të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo për shkak se këto industri mbështeten shumë në burimet natyrore, të cilat ndikohen drejtpërdrejt nga ndryshimi i modeleve klimatike.

Grupet e cënueshme brenda familjeve, si fëmijët, gratë, të moshuarit dhe individët me aftësi të kufizuara, ka të ngjarë të preken në mënyrë jo proporcionale nga ndryshimet klimatike. Ata mund të përballen me përkeqësim të

Termt dhe përkufizimet kryesore të ndryshimeve klimatike

Adaptimi: 'Përshtatjet për reduktim të cenueshmërisë ose për rritje të qëndrueshmërisë në reagimin ndaj ndryshimeve të vëzhguara ose të pritshme të klimës dhe ngjarjeve të lidhura me motin ekstrem. Përshtatja ndodh në sistemet fizike, ekologjike dhe njerëzore. Ajo përfshin ndryshime në proceset sociale dhe mjedisore, perceptimet e rrezikut klimatik, praktikat dhe funksionet për të reduktuar dëmet e mundshme ose për të realizuar mundësi të reja (PNNK, 2007).

Zbutja: 'Aftësia për të zvogëluar intensitetin e streseve natyrore (dhe të tjera) ndaj të cilave mund të ekspozohet. Meqenëse ky përkufizim sugjeron që kapaciteti i një grupi për të zbutur varet nga ashpërsia e ndikimeve, kapaciteti mund të përkufizohet si "aftësia e një vendi për të reduktuar gazrat serrë antropogjenë ose për të përmirësuar mbytet natyrore" (PNNK, 2007).

Qëndrueshmëria është kapaciteti i sistemeve (dhe komuniteteve, familjeve, individëve) për të parandaluar, zbutur ose përballuar rreziqet/goditjet, dhe për rikuperim. Një sistem është i qëndrueshëm kur është më pak i prekshëm ndaj goditjeve me kalimin e kohës, duke mundur rikuperimin me anë të përshtatjes.

Cënueshmëria është prirja për t'u ndikuar negativisht nga goditjet; është një çështje komplekse që përfshin dimensione të ndryshme. Është e dobishme të merret parasysh cënueshmëria e 'çfarë' në 'çfarë'. Faktorët strukturorë dhe të situatës në një kontekst të caktuar përcaktojnë kryesisht cënueshmërinë.

Kapaciteti adaptues i referohet "Aftësisë ose potencialit të një sistemi për t'iu përgjigjur me sukses ndryshueshmërisë dhe ndryshimit të klimës". Kapacitetet adaptuese përfshijnë strategjitë parandaluese, të cilat përfshijnë marrjen e vendimeve për të minimizuar ose shmangur një ngjarje, dhe strategji për të lehtësuar rikuperimin. Hulumtimet kanë theksuar se kapacitetet adaptuese janë të ndërlidhura dhe asnjë faktor i vetëm nuk mund të jetë përgjegjës për shkallën e cenueshmërisë së reduktuar dhe rritjen e qëndrueshmërisë në çfarëdo konteksti të caktuar.

Transmetimi i stresit klimatik mund të rritet ose reduktohet nga dobësitë specifike në çdo nivel të sistemit. Nëse familjet përballen me goditje të përsëritura që gërryejnë në mënyrë të vazhdueshme pronat e tyre, cënueshmëria ka të ngjarë të rritet ndërsa qëndrueshmëria gërryhet me kalimin e kohës. Cënueshmëria varet si nga dimensionet fizike ashtu edhe nga ato sociale – prandaj një perspektivë e cënueshmërisë sociale është thelbësore për të kuptuar pse disa individë, familje ose komunitete përjetojnë ndikimet ndryshe, edhe kur janë në të njëjtin vend.

mirëqenies dhe rritje të varfërisë, luhatje më të mëdha të mirëqenies dhe më shumë sfida në mirëmbajtjen dhe rindërtimin e pronave dhe mjeteve të jetesës pas fatkeqësive natyrore.

Paraqitja dhe intensiteti i shtuar i ekstremeve të motit, të papritura dhe graduale, janë pasoja të pritshme të ndryshimeve klimatike. Këto fatkeqësi përkeqësojnë situatën tashmë të vështirë me të cilën përballen popullatat e varfra dhe të cenueshme në Maqedoninë e Veriut dhe në Ballkan. Familjet e varfra shpesh kanë prona të kufizuara dhe përballen me diskriminim, pabarazi të institucionalizuara dhe qasje të kufizuara në punësim dhe resurse. Vitet të tera të progresit e zhvillimit mund të rrënohen nga shkatërrimi i mjeteve të jetesës dhe humbja e jetëve për shkak të menaxhimit joadekuat të rrezikut nga fatkeqësitë.

Politikat dhe mekanizmat aktualë për menaxhimin e rreziqeve klimatike në Maqedoninë e Veriut ofrojnë mbrojtje të kufizuar për familjet e cenueshme. Luhatjet në konsum dhe prona të shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe fatkeqësi të tjera kanë pasoja negative për rritjen ekonomike dhe mirëqenien e familjeve.

Pasojat imediate për familjet janë rritja e orëve të punës dhe reduktimi i burimeve për ushqim, kujdes shëndetësor dhe arsim. Pasojat afatgjata mund të përfshijnë varfërinë, të pastrehët, zvogëlimi i pronave dhe kequshqyerja. Rimëkëmbja nga fatkeqësitë është shpesh e pamjaftueshme dhe e ngadaltë, duke e bërë të vështirë për grupet e cenueshme të rindërtojnë pronat dhe të shlyejnë borxhet.

Ndihma e qeverisë dhe e donatorëve gjatë reagimit ndaj fatkeqësive natyrore në shkallë të gjerë është shpesh e pamjaftueshme, e vonuar, dhe më shumë në formë të ushqimit ose mallrave e jo në para. Kjo mbështetje është thelbësore, por zakonisht nuk është pjesë e një strategjie afatgjatë për të mbrojtur jetesën e familjeve nga fatkeqësitë. Ndihma humanitare ndërkombëtare shpesh arrin vetëm pasi një situatë ka arritur në prag të degradimit total.

Ekziston gjithashtu një shqetësim se ndihma e financuar nga donatorët mund të dekurajojë vendin nga zhvillimi dhe financimi i sistemeve të vet të mbrojtjes sociale dhe sigurimit të lidhur me motin. Familjet që pritet të përballen me rreziqe të pasiguruara mund të angazhohen në aktivitete me fitim dhe rrezik të ulët, të cilat mund të ulin efikasitetin dhe të pengojnë përpjekjet për të zbutur varfërinë.

Në përgjithësi, reagimet aktuale sociale ndaj klimës së pranishme janë të pamjaftueshme në ofrimin e masave mbrojtëse adekuate për të varfrit. Në rast se parashikimet e klimatologëve në lidhje me përshkallëzimin e paqëndrueshmërisë së motit për shkak të ndryshimeve klimatike materializohen, atëherë ekspertët për zhvillimet dhe udhëheqësit e shtetit do të duhet të parashikojnë më me kujdes se si të zbusin ndikimet negative të paqëndrueshmërisë klimatike në mirëqenien ekonomike të popullatave të varfra.

Një shembull i tillë janë përmbytjet e vitit 2021 në Shkup dhe Tetovë, të cilat shpërngulën mijëra njerëz dhe shkaktuan dëme të konsiderueshme ekonomike dhe rritën cenueshmërinë dhe varfërinë e komuniteteve. Normat e varfërisë u rritën në zonat rurale të cilat varen shumë nga bujqësia, të prekura nga përmbytjet shkatërruese, por edhe nga modele të tjera të paparashikueshme të motit. Programet ekzistuese të asistencës sociale ofrojnë përgjigje ad-hoc në ofrimin e mbështetjes gjatë dhe pas fatkeqësive të lidhura me klimën, por janë të pamjaftueshme për të siguruar zhvillim afatgjatë social.

Si përfundim, reagimet aktuale sociale ndaj paqëndrueshmërisë klimatike janë të pamjaftueshme në ofrimin e masave mbrojtëse të mjaftueshme për grupet dhe qytetarët e cenueshëm. Marrë parasysh parashikimet shkencore të klimës, ekspertët për zhvillim dhe udhëheqësit kombëtarë në Maqedoninë e Veriut dhe në Ballkan do të duhet të fokusohen më shumë në zbutjen e ndikimeve negative të ndryshimeve klimatike në mirëqenien ekonomike të popullatave të varfra.

2.3. Sfidat kryesore të ndryshimeve klimatike për projektet e zhvillimit social

Projektet e zhvillimit social kanë potencialin për të fuqizuar grupet e marginalizuara dhe të cenueshme të njerëzve për t'u bërë agjentë aktivë në ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe për t'u përfshirë në vendimmarrje.

Për të arritur përfshirjen sociale, projektet e zhvillimit social duhet të marrin parasysh më shumë dobësitë ndaj ndryshimeve klimatike që kanë njerëzit e marginalizuar në aspekt social. Vëmendje duhet t'i kushtohet kuptimit dhe reagimit ndaj dobësive specifike të personave me aftësi të kufizuara në kontekstin e ndryshimeve klimatike.

Ndryshimet klimatike paraqesin sfida të rëndësishme për projektet e zhvillimit social, pasi ato përkeqësojnë dobësitë ekzistuese dhe shkaktojnë ndërlikime të reja. Seksioni i mëposhtëm përshkruan sfidat kryesore të ndryshimeve klimatike për projektet e zhvillimit social:

➤ Rritja e cenueshmërisë së komuniteteve:

Ndryshimet klimatike prekin në mënyrë jo proporcionale komunitetet e cenueshme, duke përfshirë ato që jetojnë në varfëri, grupet e marginalizuara dhe rajonet me resurse të kufizuara. Projektet e zhvillimit social duhet të marrin në konsideratë cenueshmërinë e shtuar të këtyre komuniteteve ndaj ndikimeve të lidhura me klimën, siç janë ngjarjet ekstreme të motit dhe ndryshimi i modeleve të reshjeve. Për shembull, përmytjet dhe stuhitë e shtuara, mund të shkatërrojnë më lehtë shtëpitë dhe infrastrukturën e ndërtuar keq, duke zhvendosur banorët dhe duke ndërprerë aktivitetet ekonomike.

➤ Ndryshimi i modeleve të motit:

Ndryshimi i klimës çon në modele të paparashikueshme dhe të ndryshueshme të motit, duke përfshirë stuhitë më të shpeshta dhe më intensive, thatësi, përmytjet dhe valët e të nxehtit. Këto ndryshime mund të prishin projektet e zhvillimit social duke dëmtuar infrastrukturën, duke ndikuar në bujqësi dhe duke shkakuar zhvendosje të komuniteteve. Sfidë e veçantë për Maqedoninë e Veriut është rritja e ditëve jashtëzakonisht të nxehta të verës, që ndikon në shëndetin e njerëzve të marginalizuar, madje më shumë sesa në shëndetin e popullatës më të pasur.

➤ Siguria Ushqimore dhe Bujqësia:

Ndryshimet klimatike ndikojnë në produktivitetin bujqësor, duke kërcënuar sigurinë ushqimore. Ndryshimet në modelet e temperaturës dhe të reshjeve, së bashku me rritjen e shpeshtësisë së ngjarjeve ekstreme të motit, në veçanti përmytjet, breshrin ose thatësi mund të çojnë në reduktimin e rendimenteve të të korrave dhe shkatërrim të fushave, duke ndikuar në jetesën e

fermerëve dhe furnizimin e përgjithshëm me ushqim. Duke qenë vend bujqësor, për Maqedoninë e Veriut kjo do të thotë prishje e vazhdimësisë së furnizimit me ushqim.

➤ Mungesa e ujit dhe cilësia:

Ndryshimet në modelet e reshjeve mund të çojnë në mungesë uji në rajone të caktuara, ndërsa frekuenca e shtuar e reshjeve të dendura mund të shkaktojë përmytje duke ndikuar në cilësinë e ujit të pijshëm. Në të dyja rastet, mund të ndikojë në cilësinë e ujit, duke ndikuar në të pasurit e ujit të sigurt dhe të pastër në dispozicion për komunitetet. Një shembull: një projekt trajtimin e ujit në një komunitet mund të hasë vështirësi pasi reduktimi i reshjeve çon në mungesë uji, siç ka qenë rasti i Prilepit, dhe ngjarjet e reshjeve të shtuara e të mëdha që ndotin burimet e ujit, duke ndikuar në shëndetin dhe mirëqenien e popullatës si p.sh. vërshimet në Tetovë.

➤ Ndikimet në shëndet:

Ndryshimet klimatike mund të përkeqësojnë sfidat shëndetësore, me një rritje të përhapjes së sëmundjeve të transmetuara nga vektorët, sëmundjet e lidhura me nxehtësinë dhe përhapjen e sëmundjeve të shkaktuara nga uji. Projektet e zhvillimit social duhet t'i adresojnë këto rreziqe shëndetësore dhe të forcojnë sistemet e kujdesit shëndetësor në zonat e cenueshme. Për shembull, punëtorët në ambient të hapur janë veçanërisht të prekshëm ndaj kushteve ekstreme të motit, duke nënkuptuar vonesa për ekonominë dhe zhvillimin. Temperatura kaq të larta të verës vendi ka përjetuar vitet e fundit, kur puna në ambient të hapur është e ndaluar gjatë orëve të pikut të vapës.

➤ Migrimi dhe zhvendosja:

Ngjarjet e shkaktuara nga klima, siç janë ngjarjet ekstreme të motit dhe thatësitat e zgjatura, mund të çojnë në zhvendosje dhe migrim të popullsisë. Projektet e zhvillimit social duhet të marrin në konsideratë rritjen e mundshme të migrimit të shkaktuar nga klima dhe ndikimin e tij në strukturën sociale si të komuniteteve të origjinës ashtu edhe të destinacionit. Një projekt që synon kohezionin e komunitetit mund të sfidohet nga fluksi i migrantëve klimatikë nga zonat rurale të prekura nga thatësira, duke çuar në rritje të trysnisë mbi infrastrukturën urbane dhe shërbimet sociale. Deri më tani Maqedonia e Veriut nuk ka përjetuar situatë të ngjashme, por nuk ka garanci për të ardhmen dhe ky rrezik nuk mund të zvogëlohet.

➤ Rritja e kostove dhe kufizimet e burimeve:

Masat për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe përpjekjet e tyre për reagim shpesh kërkojnë burime financiare shtesë. Projektet e zhvillimit social mund të përballen me kosto të shtuara për shkak të nevojës për infrastrukturë rezistente ndaj klimës dhe strategjive adaptuese, që mund të shtjerrin burimet tashmë të kufizuara. Për shembull: një projekt që planifikon të instalojë panele diellore në një komunitet të largët mund të përballlet me kosto të shtuara për shkak të nevojës për pajisje dhe logjistikë të përkeqësuar më rezistente.

➤ Sfidat e politikave dhe qeverisjes:

Natyrë dinamike e ndryshimeve klimatike kërkon politika adaptuese dhe fleksibël. Projektet e zhvillimit social duhet të drejtojnë sfida komplekse të politikave dhe qeverisjes me qëllim që të

integronjë në mënyrë efektive konsideratat e ndryshimeve klimatike. Për shembull, një projekt që punon për të drejtat mbi tokën dhe zhvillim të komunitetit mund të ketë nevojë të udhëheqë ndryshimet e politikave përderisa qeveritë zbatojnë rregulloret dhe politikat e reja për të adresuar ndryshimet klimatike, të cilat mund të ndikojnë në përdorimin e tokës dhe menaxhimin e burimeve.

Adresimi i këtyre sfidave kërkon që projektet e zhvillimit social të jenë fleksibël, adaptues dhe bashkëpunues, duke përfshirë palët e interesuara në të gjitha nivelet për të zhvilluar zgjidhje që janë të qëndrueshme dhe rezistente ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë qeveritë, OJQ-të dhe komunitetet lokale, është thelbësor për ndërtimin e qëndrueshmërisë dhe sigurimin e suksesit të projekteve të zhvillimit social përballë ndryshimeve klimatike. Gjithashtu kërkohet një qasje gjithëpërfshirëse që integron qëndrueshmërinë klimatike në projektet e zhvillimit social, duke siguruar që ato të jenë të qëndrueshme dhe efektive përballë ndryshimit të kushteve klimatike në Maqedoninë e Veriut. Dimensionin – vështrimi i cenueshmërisë sociale është thelbësor për të kuptuar pse disa individë, familje ose komunitete përjetojnë ndikimet ndryshe, madje edhe kur janë në të njëjtin vend.

Sfidat specifike të ndryshimeve klimatike për zhvillimin social në Maqedoninë e Veriut:

Rritja e cenueshmërisë së komuniteteve:

Në rajonin e Pollogut, i njohur për prodhimin e tij bujqësor, komuniteti mund të përballet me rritje të cenueshmërisë për shkak të përmytjeve më të shpeshta, që ndikojnë në rendimentet e të korrave dhe mjetet për jetesë në nivel lokal.

Ndryshimi i modeleve të motit:

Në rajonin e Shkupit, projektet e zhvillimit social ë përqendruar në zhvillimin urban mund të kenë nevojë të përshtaten me modelet e reshjeve më intensive dhe më të paparashikueshme, që çojnë tek sfidat lidhur me menaxhimin e sistemeve urbane të përmytjeve dhe kullimit.

Siguria ushqimore dhe bujqësia:

Në rajonin e Pellagonisë, projektet që synojnë rritjen e sigurisë ushqimore mund të hasin vështirësi pasi ndryshimi i kushteve klimatike çon në ndryshimin e kulturave të përshtatshme bujqësore, duke kërkuar që fermerët të përshtaten me praktikatat dhe kulturatat e reja bujqësore.

Mungesa dhe cilësia e ujit:

Në pellgun e lumit Strumicë, projektet e menaxhimit të ujit mund të përballen me sfida për shkak të zvogëlimit të reshjeve dhe rritjes së shkallës së avullimit, duke çuar në mungesë uji dhe duke ndikuar si në furnizimin me ujë të pijshëm ashtu edhe në ujitje për bujqësinë.

Ndikimet në shëndet:

Në zonat urbane si Manastiri, projektet e zhvillimit social të përqendruara në shëndetin publik mund të kenë nevojë të trajtojnë problemet në rritje të frymëmarrjes dhe sëmundjet e lidhura me nxehtësinë për shkak të temperaturave më të larta dhe ndotjes së ajrit.

Migrimi dhe zhvendosja:

Zonat rurale të prekura nga rënia e produktivitetit bujqësor për shkak të ndryshimeve klimatike mund të ballafaqohen me migrim të jashtëm drejt qyteteve si Shkupi, në të cilin rast ushtrohet trysni mbi infrastrukturën dhe shërbimet urbane.

Cenueshmëria e infrastrukturës:

Në rajonet e Ohrit dhe Prespës, projektet e infrastrukturës që lidhen me turizmin mund të kenë nevojë të marrin në parasysh ndikimin përmytjeve dhe erozionit të shtuar në objektet buzë liqenit dhe vendet e trashëgimisë.

Rritja e kostove dhe kufizimet e resurseve:

Projektet që synojnë të përmirësojnë efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike mund të përballen me kosto të shtuara për shkak të nevojës për teknologji dhe materiale më të avancuara që mund t'i rezistojnë kushteve ekstreme të motit.

Sfidat e politikave dhe qeverisjes:

Projektet e zhvillimit social që punojnë në menaxhimin e tokës dhe zhvillimin rural mund të kenë nevojë të drejtojnë ndryshimet në politikatat bujqësore dhe subvencionet përderisa qeveria zbaton strategjitë për përshtatje dhe zbutje të klimës.

3. Integrimi i Ndryshimeve Klimatike në Projektet e Zhvillimit Social

Integrimi i **çështjeve lidhur me ndryshimet klimatike** në programimin e zhvillimit social është jetik për të adresuar pengesat e mundshme për përmbushjen e objektivave të zhvillimit social. Efektet negative të ndryshimeve klimatike përfshijnë një përkeqësim dhe vazhdimësi të dobësive paraprakisht ekzistuese dhe një ndikim jo proporcional te individët që jetojnë në varfëri.

Në mënyrë të ngjashme, integrimi i **perspektivës të zhvillimit social** në programet për përshtatje dhe zbutje të ndryshimeve klimatike mund të përmirësojë hartimin dhe zbatimin e masave të reagimit ndaj ndryshimeve klimatike duke avancuar qëllimet e zhvillimit social. Zbatimi i një analize të gjerë sociale në hartimin e programit të ndryshimeve klimatike mund t'i bëjë intervenimet më efektive dhe të përmirësojë kapacitetet adaptuese.

Një analizë sociale mund të jetë e dobishme për të theksuar çështjet e barazisë, drejtësisë sociale dhe midis grupeve më të marginalizuara dhe të cenueshme të popullsisë, siç janë popujt indigjenë dhe gratë.

Është me rëndësi të kryhet një **analizë sociale në fillim të hartimit të programit me qëllim që të identifikohen dhe karakterizohen efektet dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike në një zonë të caktuar**. Kjo analizë duhet të mbulojë të gjithë sektorët relevant, popullsinë dhe mjetet e jetesës. Zakonisht, cenueshmëria dhe qëndrueshmëria ndikohen nga shumë faktorë (p.sh. biofizik, social, ekonomik, politik, institucionale dhe strukturat e procese teknologjike), kështu që sistemet social-ekologjike duhet të vlerësohen duke përdorur një qasje shumëdimensionale. Kjo ofron një vështrim gjithëpërfshirës në të cilin parashikimet klimatike janë vetëm një pjesë e vlerësimit të kërcënimeve ndaj resurseve sociale dhe mjedisore.

Analizat sociale duhet të **identifikojnë vendet dhe kontekstet më të cenueshme që kanë nevojë për ndërhyrje përshtatëse dhe zbutëse**, veçanërisht shkaqet e cenueshmërisë dhe përfitimet e mundshme nga ndërhyrjet e programit për më të cenuarit. Rekomandohet përdorimi i **qasjeve poshtë-lart, gjithëpërfshirëse, të orientuara nga konteksti, të cilat përfshijnë metoda pjesëmarrëse të bazuara në komunitet** që marrin parasysh veçoritë lokale klimatike dhe jo-klimatike.

Pjesëmarrja e komunitetit në vlerësime është thelbësore – jo vetëm për mbledhjen e informacionit duke përdorur pikëpamje të ndryshme, por edhe për ndërtimin e përvetësimit të procesit nga ana e komunitetit për të rritur gjasat për zbatim të suksesshëm dhe qëndrueshmëri të ndërhyrjeve.

Metodologjitë pjesëmarrëse janë treguar të jenë vendimtare për të kuptuar dinamikën e cenueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe identifikimin e burimeve të qëndrueshmërisë. Vlerësimet e bazuara në analizat sociale mund të ndihmojnë gjithashtu në identifikimin e treguesve bazë që përfshijnë faktorë socio-ekonomikë, të mjeteve të jetesës dhe të barazisë.

3.1. Parimet për projekte të zhvillimit social të përgjegjshëm ndaj klimës

Përfshirja e rrezikut të ndryshimeve klimatike në zhvillimin social i referohet procesit të integritimit të shqetësimeve klimatike në politikat e reja dhe ekzistuese, kornizat institucionale dhe mekanizmat

vendimmarrës. Përfshirja e rreziqeve klimatike është një proces me shumë nivele, i cili kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruar të orientuar drejt reduktimit të faktorëve themelorë të cenueshmërisë së bashku me projektet dhe programet kundër klimës.

Duke u mbështetur në konceptimin e këtyllë, parimet e mëposhtme të projektimit për përfshirjen e rrezikut të ndryshimeve klimatike në kornizat kombëtare të mbrojtjes sociale (MS) mund të merren parasysh nga hartuesit e politikave sociale në MPPS:

- Vlerësimi dhe njohja e rreziqeve dhe pasigurisë që lidhen me klimën për të krijuar një këndvështrim strategjik afatgjatë.

Planifikimi i zhvillimit social të ndërgjegjshëm për klimën përfshin inkorporimin e rrezikut klimatik dhe pasigurisë në vendimmarrje. Përmirësimi i sistemeve të vlerësimit të rrezikut dhe parashikimit të klimës mund të mundësojë zbatimin e masave inovative të zhvillimit social, si sigurimi dhe financimi i bazuar në parashikime me sistemet e mbrojtjes sociale - një qasje për zbutjen e rrezikut, e cila ka potencialin për të avancuar efektivitetin e sistemeve tradicionale të paralajmërimit të hershëm dhe ndërhyrjet humanitare pas fatkeqësive. Veprimet parashikuese të mbrojtjes sociale siç është puna publike për të forcuar infrastrukturën kritike ose transfertat e pakushtëzuara të parave për të mbështetur evakuimin e njerëzve përpara një ngjarje ekstreme të parashikuar klimatike, mund të jenë një strategji efektive për të shmangur humbjet.

- Krijimi i sistemeve të mbrojtjes sociale që mundësojnë rritje të adaptimit dhe transformimit ndaj rreziqeve klimatike.

Aktivitetet e mbrojtjes sociale mund të lidhen me rritjen e masave shtesë për adaptim, pasi ato synojnë të ruajnë një nivel të caktuar mbrojtjeje dhe parandalimi kundër ndryshimeve klimatike dhe ekstremeve, dhe të ndërtojnë kapacitete përshtatëse. Njerëzit që përjetojnë humbje të aktiviteteve tradicionale të jetesës dhe stilit të jetesës për shkak të mjedisit të ndryshuar rrënjësisht ose zhvendosjes së detyruar do të kenë nevojë për mbështetje sociale për të mësuar aftësi të reja, për të krijuar raporte të reja sociale dhe për të gjetur mundësi të reja ekonomike.

- Njohja e ekzistimit të nevojës më të madhe për mbrojtje sociale të përgjegjshme ndaj klimës midis grupeve të marginalizuara shoqërore.

Hulumtimet dhe politikat për zhvillimin e mbrojtjes sociale të përgjegjshme ndaj klimës për njerëzit e marginalizuar në aspekt social siç janë minoritetet etnike, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe gratë dhe fëmijët e cenueshëm, mbeten kryesisht të papërfillur. Nevojiten më shumë hulumtime mbi cenueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike të njerëzve të marginalizuar në aspekt social. Për shembull, mungon vëmendja e përkushtuar ndaj të kuptuarit dhe reagimit ndaj dobësive specifike të personave me aftësi të kufizuara në kontekstin e ndryshimeve klimatike. Projektet dhe strategjitë e zhvillimit social duhet të kenë një fokus më të madh në fuqizimin e njerëzve të marginalizuar.

Ndërhyrje të tilla duhet të integrohen më mirë me programet e gatishmërisë, ndihmës dhe rindërtimit për fatkeqësitë, p.sh. jo vetëm nëpërmjet skemave të transferimit të parave të gatshme, por edhe nëpërmjet programeve të punës publike për rindërtimin pas fatkeqësisë që synojnë përmirësimin e qasjes të personave me aftësi të kufizuara në shërbimet bazë dhe rrugët e evakuimit. Identifikim i masave specifike për zonat rurale dhe urbane, duke përfshirë strategjitë për trajtimin e migracionit.

Popullatat rurale dhe urbane përballen me rreziqe të ndryshme të lidhura me klimën pasi ekspozimi dhe cenueshmëria e tyre kushtëzohen nga faktorë qenësisht të ndryshëm.

Me mjetet e tyre për jetesë të varura pothuajse tërësisht nga burimet natyrore dhe sektorët ekonomikë të ndjeshëm ndaj klimës, miliona njerëz që jetojnë në zonat rurale janë të cenueshëm ndaj ndikimeve nga ndryshimet klimatike. Shumica e popullsisë jeton në qytete, (vetëm në Shkup jeton gati 33% nga popullsia e përgjithshme e vendit) popullsia urbane po rritet me shpejtësi dhe varfëria po urbanizohet me shpejtësi. Përqendrimi i lartë i grupeve të varfëra dhe të cenueshme në vendbanimet e vendosura në zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë është një problem i madh veçanërisht në qendrat urbane, p.sh. në Shkup. Është e rëndësishme të theksohet se shumë pakica etnike dhe migrantë që jetojnë në varfëri nuk kanë status formal qëndrimi dhe punësimi, dhe si pasojë nuk kanë as qasje në mbrojtjen formale sociale duke përfshirë sigurimin shëndetësor. Për më tepër, banorët e rinj urbanë, veçanërisht banorët joformalë, shpesh përjashtohen nga rrjetet dhe mekanizmat mbështetës të bazuar në komunitet. Autoritetet urbane kanë një rol të madh në mbrojtjen sociale pasi ato shpesh janë përgjegjëse për të siguruar që qytetarët të kenë qasje adekuate në shërbimet bazë, objektet e shëndetit dhe sigurisë publike dhe informacionin e paralajmërimit të hershëm. Ndryshimet klimatike ka mundësi të dëmtojnë përpjekjet për të zgjeruar mbulimin e sigurimit shëndetësor dhe për të përmirësuar qasjen në kujdesin thelbësor shëndetësor në zonat rurale dhe urbane në vendet në zhvillim. Në disa vende, ngjarjet e ndryshimeve klimatike si përmbytjet sezonale më të shpeshta dhe të rënda do të zvogëlojnë qasjen fizike të komuniteteve rurale në objektet e kujdesit shëndetësor. Prandaj, është thelbësore për Maqedoninë e Veriut që të forcojë dhe të bëjë rezistente ndaj klimës politikat e saj të zhvillimit social në fushën e shëndetësisë, duke marrë parasysh rreziqet diferenciale të lidhura me ndryshimet klimatike në zonat rurale dhe urbane. Strategjitë kombëtare të zhvillimit social duhet të hartohen për të parashikuar dhe trajtuar lëvizshmërinë e brendshme të shkaktuar nga klima.

- Lehtësimi i një tranzicioni të drejtë në ekonomi të gjelbër.

Rrugët e zhvillimit e rritjes së gjelbër duhet të adresojnë degradimin mjedisor dhe ndryshimet klimatike dhe të promovojnë qëndrueshmërinë dhe barazinë ndër breza. Politikat e gjelbra mund të krijojnë mundësi të reja ekonomike dhe punësimi nga të cilat mund të përfitojnë të varfrit në afat të gjatë, nëse programet e PS-së si zhvillimi i aftësive janë rezistente nga klima. Megjithatë, politikat mjedisore mund të kenë një ndikim negativ social, veçanërisht te njerëzit, mjetet e jetesës së të cilëve varen nga praktikat karbon-intensive dhe të paqëndrueshme. GIZ publikoi një dokument diskutimi mbi “Aftësitë për një tranzicion të drejtë për një të ardhme të gjelbër” i cili eksploron se si projektet në fushën e zhvillimit të aftësive mund të promovojnë një tranzicion të gjelbër.¹¹

Zhvillimi social shihet gjithnjë e më shumë si një instrument për të mbështetur tranzicionin e drejtë drejt rritjes së gjelbër duke mbrojtur grupet e cenueshme dhe duke luftuar varfërinë e pabarazinë sociale. Vendi tashmë njihet nevojën për integrimin e reformave pro-klimatike me zhvillimin social në formë të përfitimeve për të papunësuarit, programeve të transfertave sociale dhe trajnimeve për njerëzit e prekur nga rregulloret mjedisore. Politikat e zhvillimit social mund të hartohen për të mbështetur grupet e cenueshme nëpërmjet: (i) iniciativave të zhvillimit të gjelbër në shkallë të vogël që synojnë krijimin e mundësive të punësimit dhe biznesit dhe përmirësimin e jetesës; dhe (ii)

¹¹ 2022, GIZ: Dokument diskutimi. Aftësitë për një tranzicion të drejtë për një të ardhme të gjelbër. E aksesueshme këtu: https://www.giz.de/fachexpertise/downloads/27_giz2022-0387en-just-transition-green-future.pdf

programet e mbështetjes dhe asistencës sociale të dizajnuara për të adresuar rreziqet që dalin nga politikat dhe rregulloret e reja mjedisore, p.sh. nga mekanizmat që synojnë rezistencën kundër klimës dhe zhvillimi i instrumenteve të përshtatshme.

Seksioni në vijim vendosë në kontekst parimet e paraqitura për Maqedoninë e Veriut dhe jep shembuj se si parimet e sugjeruara mund të zbatohen në Maqedoninë e Veriut.

- Vlerësimi dhe njohja e rreziqeve dhe pasigurisë që lidhen me klimën:

Urban: Integrimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe planeve të evakuimit në projektet e zhvillimit social për zonat urbane të prirura ndaj përmbytjeve, siç janë pjesë të Shkupit, për të mbrojtur banorët dhe për të zvogëluar ndikimin e ngjarjeve ekstreme të motit.

Rural: Integrimi i projekteve sociale me iniciativa të tjera, për shembull praktikat bujqësore rezistente ndaj thatësirës dhe ofrimi i trajnimeve për fermerët në rajonet rurale si Pellagonia për të rritur qëndrueshmërinë e tyre ndaj ndryshimit të kushteve klimatike.

- Merrja parasysh e rreziqeve klimatike në projektet e mbrojtjes sociale dhe të zhvillimit:

Urban: Integrimi i mjeteve të vlerësimit të rrezikut klimatik (planifikim i bazuar në skenar, vendimmarrje të fuqishme) për zhvillime të reja urbane, master-plane, hapësira publike, projekte sociale.

Rural: Vlerësimi i përmirësuar i rrezikut dhe parashikimi i klimës mund të rrisë qëndrueshmërinë e popullsisë rurale duke bërë zgjedhje më të mira për praktikat bujqësore të bazuara në informacione. Gjithashtu, si masë e mbrojtjes sociale mund të mundësojë zbatimin e sigurimeve të bazuara në indeks.

- Njohja e nevojës më të madhe për mbrojtje sociale të përgjegjshme ndaj klimës midis grupeve të marginalizuara në aspekt social të Maqedonisë së Veriut:

Urban: Ofrimi i mbështetjes të synuar për grupet e cënueshme urbane, siç janë pakicat etnike, duke siguruar qasje në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet sociale përballë rreziqeve shëndetësore të shkaktuara nga klima.

Rural: Rritja e qëndrueshmërisë së komuniteteve rurale me një përqindje të lartë të grupeve të marginalizuara sociale, si popullsia romë, duke ofruar resurse dhe trajnime të përshtatura për klimën.

- Lehtësimi i një tranzicioni të drejtë për një ekonomi të gjelbër:

Urban: Mbështetja e zhvillimit të industrive të gjelbra në qendrat urbane, duke ofruar trajnime dhe mbrojtje sociale për punëtorët që kalojnë nga sektorët tradicionalë në ato të gjelbër.

Rural: Zbatimi i programeve të zhvillimit rural që fokusohen në bujqësi të qëndrueshme dhe energji të rinovueshme, duke krijuar mundësi të reja ekonomike dhe duke reduktuar varësinë nga praktikat e paqëndrueshme.

Duke marrë parasysh parimet e propozuara dhe duke i inkorporuar ato në programet e MPPS-së, Maqedonia e Veriut mund të sigurojë që projektet e saj të zhvillimit social të jenë të përgjegjshme

ndaj klimës dhe të dobishme për popullsinë urbane dhe rurale, duke adresuar sfidat dhe mundësitë unike të paraqitura nga ndryshimet klimatike në secilin kontekst.

Shembuj se si programet e MPPS në Maqedoninë e Veriut mund të sigurojnë përfitime për popullsinë urbane dhe rurale

➤ Programet universale me masa të synuara:

Ndihma Sociale: Zgjerimi i programeve ekzistuese të ndihmës sociale (p.sh. asistenca minimale e garantuar) për të mbuluar goditjet e shkaktuara nga klima me të cilat përballen popullsia urbane dhe rurale. Për shembull, sigurimi i asistencës së përkohshme financiare gjatë thatësirave që prekin të ardhurat bujqësore në zonat rurale ose gjatë përmbytjeve që prekin punëtorët informalë në zonat urbane.

Shërbimet e kujdesit për fëmijët: Rritja e qasjes në shërbime financiarisht të përballueshme të kujdesit për fëmijët në zonat urbane dhe rurale, duke u mundësuar prindërve, veçanërisht grave, të marrin pjesë në fuqinë punëtore dhe të përshtaten me sfidat e lidhura me klimën. Ofrimi i subvencioneve për transport ose njësi mobile të kujdesit për fëmijët në zonat rurale.

Zhvillimi i aftësive: Zbatimi i programeve të trajnimit për popullsinë urbane dhe rurale të përqendruara në punët e gjelbra dhe mjete për jetesën rezistente ndaj klimës. Ofrimi i mundësisë për mësim online për banorët ruralë dhe përshtatje të trajnimeve për nevojat specifike rajonale (p.sh. bujqësi e qëndrueshme në zonat rurale, ndërtimi i gjelbër në zonat urbane).

➤ Masat specifike urbane:

Zbutja e ishullit të nxehtësisë urbane: Mbështetje të iniciativave për mbjelljen e pemëve, krijimin e hapësirave të gjelbra dhe përmirësimin e izolimit të ndërtesave në zonat urbane për të luftuar temperaturat në rritje dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit.

Gatishmëria ndaj fatkeqësive: Investim në sistemet e paralajmërimit të hershëm, planet e evakuimit dhe strehimoret emergjente posaçërisht për popullatat urbane të cenueshme që jetojnë në zonat e rrezikuara nga përmbytjet si Shkupi, Tetova ose zonat me rrëshqitje të dheut si Rostusha, Dibra.

Transporti publik: Promovimi dhe subvencionimi i opsioneve të qëndrueshme të transportit publik si autobusët, tramvajet dhe infrastruktura e çiklizmit për të reduktuar nxehtësinë urbane dhe emetimet e karbonit, duke përfituar si banorët ashtu edhe turizmi.

➤ Masat specifike për zonat rurale:

Bujqësia e mençur ndaj klimës: Ofrimi i burimeve dhe trajnimeve për fermerët në përvetësimin e praktikave bujqësore rezistente ndaj klimës si kulturat bujqësore rezistente ndaj thatësirës, teknikat e ruajtjes së ujit dhe agro-pylltaria.

Mikro-financimi Rural: Lehtësimi i qasjes në mikrokredi për komunitetet rurale për të investuar në infrastrukturë rezistente ndaj klimës, si sistemet e përmirësuara të ujitjes ose zgjidhjet e energjisë së rinovueshme në shkallë të vogël.

Lidhshmëria rurale: Rritja e qasjes në internet me brez të gjerë në zonat rurale për të mundësuar qasje në mundësitë e arsimit në distancë, telemjekësisë dhe tregtisë elektronike, duke nxitur përshtatjen dhe diversifikimin ekonomik.

➤ Masa të tjera:

Dialogu Social: Angazhimi me drejtuesit e komunitetit, OJQ-të dhe aktorët e sektorit privat si në zonat urbane ashtu edhe rurale për të kuptuar nevojat specifike dhe për të përshtatur programet në përputhje me rrethanat.

Qasje e bazuar në të dhënat: Përdorimi i të dhënave për rreziqet klimatike, popullatat e cenueshme dhe efektivitetin e programit për të monitoruar progresin dhe për të informuar ndërhyrjet e ardhshme.

Qëndrueshmëria afatgjatë: Integrimi i masave për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në strategjitë për zhvillim më të gjerë dhe sigurimi i qëndrueshmërisë financiare nëpërmjet burimeve të ndryshme të financimit.

Duke i zbatuar masat qëllimore si këto të propozuarat, MPPS mund të sigurojë që programet e saj të adresojnë në mënyrë efektive nevojat e ndryshme të popullsisë urbane dhe rurale përballë ndryshimeve klimatike, duke nxitur qëndrueshmërinë dhe duke promovuar zhvillim të barabartë në të gjithë vendin.

3.2. Bashkëpunimi me palët e interesuara

Është e rëndësishë së veçantë përfshirja e grupeve të ndryshme të palëve të interesuara në të gjitha fazat e projektit, përfshirë planifikimin, projektimin, zbatimin dhe monitorimin. Kjo, për t'u siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe nevojat e tyre të merren parasysh në proces. Të dhënat e nxjerra nga konsultimet, intervistat dhe metodologjitë pjesëmarrëse do të ofrojnë narrative të rëndësishme cilësore, duke nxjerrë në pah perceptimet dhe pikëpamjet e palëve të interesuara dhe duke lehtësuar identifikimin e ndryshimeve dhe rezultateve të dëshiruara.

Zbatimi i një qasjeje pjesëmarrëse do të sjellë një vërtetim dhe trajtim gjithëpërfshirës të nevojave të grupeve të ndryshme sociale të dala nga aspektet e ndryshimeve klimatike. Një strukturë ekzistuese që ka potencialin për të vepruar si mekanizëm për bashkëpunim mes palëve të interesuara është Këshilli Ekonomik dhe Social (i koordinuar nga MPPS).

Ashtu si çdo integrim i sektorëve që kryesisht kanë punuar brenda fushëveprimit të vet, do të jetë e rëndësishme që të bashkohen palët e interesuara nga të dy sektorët – adaptimi dhe zbutja e ndryshimeve klimatike dhe zhvillimi social.

Palët e interesuara për të bashkëpunuar mund të jenë:

- Agjencitë qeveritare: MPPS, ministritë dhe departamentet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, planifikimin urban dhe zhvillimin ekonomik duhet të punojnë së bashku për të formuluar politika dhe të ndajnë resurse për projekte të përgjegjshme ndaj klimës.

- Komunat vendore: Qeverisjet lokale luajnë një rol vendimtar në zbatimin e masave për përshtatjen dhe zbutjen e klimës në nivel komuniteti. Ato janë përgjegjës për zhvillimin e infrastrukturës, planifikimin e përdorimit të tokës dhe ofrimin e shërbimeve thelbësore për banorët.
- OJQ-të dhe organizatat e shoqërisë civile: Organizatat joqeveritare dhe grupet e shoqërisë civile shpesh kanë ekspertizën në angazhimin me komunitetin, avokimin dhe iniciativat bazë. Ato mund të kontribuojnë duke rritur ndërgjegjësimin, duke mobilizuar resurset dhe duke zbatuar projekte që trajtojnë aspektet sociale të ndryshimeve klimatike.
- Institucionet Akademike dhe Kërkimore: Universitetet, institutet hulumtuese dhe organizatat kërkimore mund të ofrojnë kërkime të vlefshme, analiza të të dhënave dhe ekspertizë teknike për të informuar për hartimin dhe zbatimin e projekteve të përgjegjshme ndaj klimës.
- Bizneset dhe industria: Kompanitë e sektorit privat luajnë një rol në investimin në teknologjitë e qëndrueshme, përvetësimin e praktikave miqësore për mjedisin dhe mbështetjen e nismave të zhvillimit të komunitetit që kontribuojnë në rezistencën ndaj e klimës.
- Organizatat ndërkombëtare dhe donatorët: Bashkëpunimi me organizata dhe donatorë ndërkombëtarë, si Fondi i Gjelbër i Klimës, mund të sigurojë qasje në fonde, asistencë teknike dhe në praktikat më të mira nga vende të tjera.
- Anëtarët e komunitetit: Puna me komunitetet lokale është thelbësore për suksesin e projekteve të përgjegjshme ndaj klimës. Njohuritë, prioritetet dhe nevojat e tyre duhet të merren parasysh gjatë planifikimit dhe zbatimit të projektit për të siguruar rëndësinë dhe efektivitetin.

Prandaj, është e rëndësishme që të:

- Ndani informacionin: informimi i të gjitha palëve të interesuara;
- Mbani konsultime: sigurimi i rrjedhjes së shumanshme të informacionit për vendosjen të dialogut më të ngushtë;
- Merrni vendime: përfshirja e përfaqësuesve të nivelit të lartë të të gjitha palëve të interesuara në marrjen e vendimeve;
- Inicioni veprime: pasi niveli më i lartë i pjesëmarrjes arrihet kur të gjitha palët e interesuara inicionë veprime të reja.

3.3. Mangësitë dhe sfidat në lidhjen e ndryshimeve klimatike me projektet e zhvillimit social

Lidhja e ndryshimeve klimatike me projektet e zhvillimit social mund të jetë sfiduese për shkak të disa mangësive dhe çështjeve që duhen adresuar. Në vazhdim janë disa nga sfidat dhe mangësitë kryesore:

Ndërlidhja komplekse: Ndryshimi i klimës dhe zhvillimi social janë të ndërlidhura në mënyrë komplekse, por ndërvarësia e tyre mund ta bëjë sfidues hartimin e projekteve që trajtojnë në

mënyrë efektive të dyja çështjet në të njëjtën kohë. Mund të mungojnë qasjet gjithëpërfshirëse që marrin në konsideratë marrëdhëniet e shumanshme midis ndikimeve nga ndryshimet klimatike dhe qëllimeve të zhvillimit social.

Dobësitë e ndryshme: Komunitete dhe grupe të ndryshme sociale kanë dobësi të ndryshme si ndaj ndryshimeve klimatike ashtu edhe ndaj çështjeve të zhvillimit social. Identifikimi dhe adresimi i këtyre dobësive të ndryshme është një detyrë komplekse. Qasjet e njëanshme mund të mos jenë të përshtatshme, duke bërë që komunitetet e marginalizuara të lihen jashtë ose të mos mbështeten në mënyrë adekuate në hartimin e projekteve.

Shpërndarja e resurseve dhe konkurrenca: Resurset e kufizuara mund të çojnë në konkurrencë midis projekteve për ndryshimet klimatike dhe atyre të zhvillimit social lidhur me financim e tyre dhe tërheqjen vëmendje. Prioritizimi mund të shkojë në favor të një aspekti kundër tjetrit, me mundësi për të lënë çështje të rëndësishme të pa trajtuara dhe duke përkeqësuar sfidat ekzistuese.

Mospërputhja e horizontit kohor: Ndryshimi i klimës shpesh vepron në shkallë më të gjata kohore, ndërsa projektet e zhvillimit social mund të synojnë ndikime më të menjëhershme. Përafrimi i afateve kohore të projektit për të adresuar sfidat afatshkurtra dhe afatgjata mund të jetë i vështirë. Projektet mund të përqendrohen më shumë në nevojat e menjëhershme sociale, duke mospërfillur ndërtimin afatgjatë të qëndrueshmërisë që kërkohet për të adresuar ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Mangësitë e të dhënave dhe njohurive: Në shumë rajone, ka mungesë të të dhënave dhe njohurive gjithëpërfshirëse në lidhje me ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe treguesit e zhvillimit social. Informacioni i pamjaftueshëm mund të pengojë planifikimin dhe zbatimin efektiv të projektit, duke e bërë të vështirë përshtatjen e ndërhyrjeve për nevojat specifike të komuniteteve.

Bashkëpunimi ndër-sektorial : Integrimi efektiv i ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit social kërkon bashkëpunim ndërmjet sektorë të ndryshëm, duke përfshirë mjedisin, shëndetësinë, arsimin dhe infrastrukturën. Qasjet e heshtura dhe mungesa e koordinimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm mund të pengojnë zhvillimin e strategjive gjithëpërfshirëse që trajtojnë si çështjet klimatike ashtu edhe ato sociale.

Politikat dhe Barrierat Institucionale: Politikat ekzistuese dhe strukturat institucionale mund të mos jenë të favorshme për integrimin e ndryshimeve klimatike dhe qëllimeve të zhvillimit social. Mungesa e koherencës së politikave dhe kornizave institucionale mund të pengojë zbatimin e suksesshëm të projekteve që synojnë të adresojnë të dyja sfidat në të njëjtën kohë.

Angazhimi dhe pjesëmarrja e komunitetit: Sigurimi i angazhimit kuptimplotë të komunitetit dhe pjesëmarrja në projekte është thelbësore për suksesin, por mund të jetë sfiduese përfshirja efektive e komuniteteve në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes. Projektet mund të përballen me vështirësi në arritjen e rezultateve të qëndrueshme nëse nuk marrin parasysh perspektivat, nevojat dhe njohuritë e komuniteteve lokale.

Adresimi i këtyre sfidave dhe plotësimi i boshllëqeve të identifikuar kërkon një qasje multi-disiplinore dhe bashkëpunuese, duke përfshirë qeveritë, OJQ-të, komunitetet dhe sektorin privat. Zhvillimi i zgjidhjeve novatore dhe specifike për kontekstin që marrin në konsideratë ndërveprimin

dinamik midis ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit social është thelbësor për arritjen e ndikimeve pozitive afatgjata.

4. Udhëzues hap pas hapi për integrimin e ndryshimeve klimatike në projektet e zhvillimit social

Ky seksion paraqet një udhëzim praktik hap pas hapi për përfshirjen e aspekteve të ndryshimeve klimatike në projektet e zhvillimit social.

1. Analiza e cenueshmërisë:

Së pari, bëni një analizë të plotë të cenueshmërisë për të kuptuar se si ndryshimi i klimës ndikon ndryshe tek gratë, burrat dhe grupet e cenueshme. Më pas identifikoni pabarazitë në qasje në resurse, vendimmarrje dhe mundësitë që lidhen me projektin.

2. Angazhimi i palëve të interesuara:

Përfshini grupe të ndryshme të cenueshme në të gjitha fazat e projektit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, zbatimin dhe monitorimin. Sigurohuni që zëri i tyre të dëgjohet dhe nevojat e tyre të merren parasysh.

3. Ndërtimi i kapaciteteve:

Investoni në aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve për të rritur njohuritë dhe aftësitë e komuniteteve të cenueshme për të marrë pjesë aktive në projekt dhe për t'iu përshtatur ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

4. Mbledhja dhe analiza e të dhënave:

Mblidhni të dhëna të kategorizuara sipas gjinisë dhe cenueshmërisë dhe sigurohuni që reflektimet të integrohen në mbledhjen e të dhënave dhe proceset e analizës së projektit. Këto të dhëna do të ndihmojnë në gjurmimin e ndikimit të projektit në grupe të ndryshme të cenueshme.

5. Politikat dhe rregulloret e përgjegjshme:

Sigurohuni që hartimi dhe zbatimi i projektit i përmbahet politikave dhe rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare. Promovoni kornizat ligjore që mbështesin mundësi të barabarta për të gjithë.

6. Shëndeti dhe mirëqenia:

Merrni parasysh shëndetin dhe mirëqenien e përfituesve të projektit, veçanërisht të grupeve të cenueshme, duke integruar në projektet klimatike aspekte siç janë uji i pastër, kanalizimi dhe kujdesi shëndetësor. Ndikimet klimatike mund të ndikojnë në rezultatet shëndetësore.

7. Monitorimi dhe vlerësimi:

Zhvilloni një sistem të fuqishëm monitorimi dhe vlerësimi që ndjek ndikimet e projektit. Vlerësoni rregullisht nëse projekti po i arrin qëllimet e tij në aspektin e barazisë gjinore dhe grupeve të cenueshme.

8. Menaxhimi adaptues:

Jini të përgatitur për të përshtatur projektin sipas nevojës bazuar në kushtet e ndryshimit të klimës dhe nevojat në zhvillim të komuniteteve të prekura. Përfshini reagimet nga palët e interesuara, veçanërisht grupet e cenueshme.

9. Ndarja e njohurive:

Promovoni ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira në lidhje me integrimin e grupeve të cenueshme në projektet klimatike që të siguroni që mësimet e nxjerra të zbatohen në iniciativat e ardhshme.

4.1. Identifikimi i rreziqeve lidhur me klimën (vlerësimi i rrezikut të klimës)

Vlerësimi i rrezikut të klimës është një proces i vlerësimit të ndikimeve të mundshme, dobësive dhe rreziqeve që lidhen me ndryshimet klimatike në sisteme, sektorë ose komunitete të ndryshme. Ai përfshin analizimin e gjasave dhe ashpërsisë së rreziqeve të lidhura me klimën dhe pasojave të tyre të mundshme. Në vijim janë detajet për hapat zakonisht të përdorur për vlerësim të rrezikut klimatik:

➤ Identifikimi i rreziqeve klimatike:

Rreziqet klimatike janë ngjarje të pafavorshme të motit dhe klimës, siç janë temperaturat ekstreme, stuhitë, përmytjet, thatësitat dhe ngritja e nivelit të detit. Është e rëndësishme të identifikohen dhe karakterizohen rreziqet klimatike që janë të rëndësishme për rajonin, sektorin apo sistemin specifik që është në vlerësim.

➤ Vlerësimi i cenueshmërisë:

Cenueshmëria i referohet shkallës në të cilën një sistem, komunitet ose sektor është i ndjeshëm ndaj dëmtimit nga rreziqet klimatike. Prandaj, vlerësoni ndjeshmërinë, ekspozimin dhe kapacitetin adaptues të sistemit ose komunitetit. Kjo përfshin të kuptuarit se si faktorët socialë, ekonomikë dhe mjedisorë kontribuojnë në cenueshmërinë.

➤ Vlerësimi i ndikimit:

Vlerësimi i ndikimit përfshin analizimin e pasojave të mundshme të rreziqeve klimatike në aspekte të ndryshme të sistemit ose komunitetit, si infrastruktura, ekosistemet, shëndeti i njerëzve dhe aktivitetet ekonomike. Është i nevojshëm kualifikimi i ndikimeve të mundshme, duke marrë parasysh si efektet direkte ashtu edhe ato indirekte. Ky hap ndihmon për të kuptuar madhësinë dhe natyrën e rreziqeve që lidhen me ndryshimin e klimës.

➤ Analiza e rrezikut:

Rreziku është kombinimi i probabilitetit të ndodhjes së një ngjarjeje dhe pasojave ose ndikimeve të asaj ngjarje. Kombinoni informacionin nga identifikimi i rrezikut, vlerësimi i cenueshmërisë dhe vlerësimi i ndikimit për të kryer një analizë gjithëpërfshirëse të rrezikut. Kjo përfshin llogaritjen e gjasave dhe ashpërsisë së rreziqeve të ndryshme të lidhura me klimën.

➤ Zhvillimi i skenarit:

Skenarët përfshijnë ndërtimin e kushteve të mundshme të së ardhmes bazuar në faktorë të ndryshëm klimatikë dhe socio-ekonomikë. Zhvilloni skenarë që karakterizojnë të ardhmet e ndryshme të mundshme, duke përfshirë parashikime të ndryshme të ndryshimeve klimatike dhe shtigje të zhvillimit socio-ekonomik. Këta skenarë ndihmojnë në eksplorimin e një sërë rezultatesh të mundshme dhe planifikim të pasigurisë.

➤ Opsionet dhe strategjitë e përshtatjes:

Përshtatja përfshin rregullimin e politikave, praktikave dhe sistemeve për të reduktuar ndikimet negative të ndryshimeve klimatike dhe për të përfituar nga oportunitetet e mundshme. Është e rëndësishme të identifikohen dhe vlerësohen opsionet dhe strategjitë e përshtatjes që mund të rrisin qëndrueshmërinë dhe të zvogëlojnë cenueshmërinë. Kjo mund të përfshijë përmirësime të infrastrukturës, ndryshime në planifikimin e përdorimit të tokës dhe zhvillimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm.

➤ Integrimi në vendimmarrje:

Integrimi i vlerësimit të rrezikut klimatik në proceset e vendimmarrjes mundëson që informacioni të përdoret për të informuar politikën, strategjitë dhe investimet. Është thelbësore të punohet ngushtë me palët e interesuara, politikëbërësit dhe përfaqësuesit e komunitetit me qëllim integrimin e gjetjeve të vlerësimit të rrezikut klimatik në proceset vendimmarrëse në nivele të ndryshme.

➤ Monitorimi dhe rishikimi:

Monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi periodik janë thelbësore për përditësimin e vlerësimit dhe përshtatjen e strategjive kur vihet në dispozicion informacioni i ri. Pra, krijimi i një kuadri monitorimi dhe rishikimi për të ndjekur ndryshimet në kushtet klimatike, dobësitë dhe efektivitetin e masave përshtatëse të zbatuara është një domosdoshmëri.

Vlerësimi i rrezikut të klimës është një proces dinamik dhe përsëritës që duhet të përditësohet rregullisht për të reflektuar shkencën e klimës në zhvillim, kushtet socio-ekonomike dhe nevojat për përshtatje. Ai siguron një bazë për vendimmarrje të informuar dhe ndihmon në ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

4.2. Identifikimi i dobësive

Identifikimi i dobësive në ndryshimet klimatike dhe projektet e zhvillimit social përfshin një vlerësim sistematik të faktorëve që mund t'i bëjnë individët, komunitetet ose sistemet më të prekshëm ndaj

ndikimeve negative. Në vazhdim janë hapat kryesorë për të ndihmuar në identifikimin e dobësive në projekte të tilla:

➤ Angazhimi i palëve të interesuara:

Bashkëpunoni me komunitetet lokale, aktorët përkatës dhe ekspertët për të kuptuar perspektivat dhe përvojat e tyre. Kryeni intervista, diskutime në fokus grupe ose sondazhe për të mbledhur informacion mbi dobësitë ekzistuese, nevojat dhe aspiratat e komunitetit.

➤ Analiza kontekstuale:

Kuptoni kontekstin social, ekonomik dhe mjedisor të zonës së projektit. Analizoni tendencat demografike, strukturat ekonomike, infrastrukturën ekzistuese dhe kushtet mjedisore për të identifikuar dobësitë e mundshme.

➤ Vlerësimi i rrezikut klimatik:

Identifikoni rreziqet specifike të lidhura me klimën që paraqesin rreziqe për zonën e projektit. Vlerësoni të dhënat historike të klimës, parashikimet klimatike dhe njohuritë lokale për të identifikuar rreziqet e mundshme si përmbytjet, thatësitrat, stuhitë ose valët e të nxehtit.

➤ Vlerësimi i cenueshmërisë socio-ekonomike:

Vlerësoni dobësitë ekzistuese brenda strukturës sociale të komunitetit ose sistemit. Analizoni faktorët siç janë nivelet e varfërisë, qasja në arsim, kujdesi shëndetësor, mundësitë e punësimit dhe kohezioni social. Identifikoni grupet që mund të jenë më të cenueshme, si gratë, fëmijët, të moshuarit ose komunitetet e marginalizuara.

➤ Cenueshmëria e infrastrukturës dhe resurseve:

Vlerësoni cenueshmërinë e infrastrukturës dhe resurseve kritike. Vlerësoni qëndrueshmërinë e infrastrukturës ekzistuese (p.sh. ndërtesat, rrugët, sistemet e furnizimit me ujë) ndaj ndikimeve klimatike. Vlerësoni disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e burimeve kryesore si uji, energjia dhe ushqimi.

➤ Shëndeti dhe mirëqenia:

Vlerësoni ndikimet e mundshme shëndetësore nga projekteve për ndryshimet klimatike dhe të zhvillimit social. Vlerësoni prevalencën e problemeve shëndetësore ekzistuese, qasjen në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe potencialin për rritjen e rreziqeve shëndetësore për shkak të ndryshimeve klimatike (p.sh., sëmundjet e transmetuara nga vektorët, sëmundjet e lidhura me nxehtësinë).

➤ Mjetet e jetesës dhe cenueshmëria ekonomike:

Kuptoni varësinë e komunitetit nga aktivitetet specifike ekonomike dhe cenueshmërinë e këtyre aktiviteteve ndaj ndryshimeve klimatike. Analizoni burimet kryesore të jetesës, si bujqësia, peshkimi ose turizmi. Vlerësoni ndjeshmërinë e këtyre aktiviteteve ndaj ndryshimeve të lidhura me klimën.

➤ Njohuri kulturore dhe autoktone:

Njihni rëndësinë e praktikave kulturore dhe njohurive indigjene gjatë formësimit të cënueshmërisë. Konsultohuni me komunitetet lokale për të kuptuar njohuritë dhe praktikat tradicionale që kontribuojnë në qëndrueshmërinë ose cënueshmërinë. Përfshijeni këtë njohuri në planifikimin e projektit.

➤ Analiza institucionale dhe e qeverisjes:

Vlerësoni kapacitetin e institucioneve vendore dhe strukturave qeverisëse për t'iu përgjigjur sfidave të lidhura me klimën. Vlerësoni efektivitetin e qeverisjes vendore, organizatave të komunitetit dhe institucioneve të tjera në menaxhimin dhe reagimin ndaj rreziqeve klimatike. Identifikoni dobësitë e kapaciteteve institucionale.

➤ Edukimi dhe ndërgjegjësimi:

Vlerësoni nivelin e ndërgjegjësimit dhe të të kuptuarit të ndryshimeve klimatike dhe ndikimeve të tij brenda komunitetit. Matni njohuritë dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve të komunitetit në lidhje me ndryshimet klimatike dhe aftësinë e tyre për t'u përshtatur. Identifikoni mundësitë për ngritjen e kapaciteteve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere.

➤ Analiza gjinore:

Identifikoni dobësitë dhe mundësitë specifike gjinore. Kryeni një analizë gjinore për të kuptuar se si ndryshimi i klimës ndikon ndryshe tek burrat dhe gratë. Identifikoni rolet, përgjegjësitë dhe qasjen në burime specifike gjinore.

➤ Qasshmëria e të dhënave dhe teknologjisë:

Vlerësoni disponueshmërinë dhe qasjen e të dhënave dhe teknologjisë për monitorimin dhe reagimin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Vlerësoni qasjen e komunitetit në informacionin klimatik, sistemet e paralajmërimit të hershëm dhe teknologjinë që mund të rrisë qëndrueshmërinë.

Me trajtimin sistematik të këtyre aspekteve, planifikuesit dhe zbatuesit e projektit mund të fitojnë një kuptim gjithëpërfshirës të dobësive dhe të zhvillojnë strategji që janë më përfshirëse, adaptuese dhe më të qëndrueshme. Kjo qasje siguron që projektet e ndryshimit të klimës dhe zhvillimit social të përshtaten më mirë me nevojat dhe sfidat specifike të komuniteteve që synojnë të përfitojnë.

4.3. Veçoritë dhe opsionet e projekteve të zhvillimit social të përgjegjshëm ndaj klimës

Projektet e zhvillimit social të përgjegjshëm ndaj klimës duhet të integrojnë elemente të dizajnit dhe zgjedhje që mundësojnë aftësinë e tyre për t'u përshtatur me ndryshimet klimatike dhe për të lehtësuar efektet nga ato. Për të arritur këtë objektiv, mund të aplikohen një sërë karakteristika të rëndësishme të dizajnit. Këto përfshijnë iniciativa adaptuese dhe të dobishme që mund të zgjerojnë shtrirjen e tyre në përgjigje të katastrofave të lidhura me klimën, sistemet e synuara që u përgjigjen kushteve klimatike, investimet në mjetet e qëndrueshme të jetesës që rrisin qëndrueshmërinë në nivel komuniteti dhe familjeje, dhe promovimin e menaxhimit të përmirësuar të rrezikut klimatik.

Procesi i integruar i dizajnit për krijimin e ndërtesave reaguese ndaj klimës përfshin elementë të tillë si diversiteti i aspekteve të projektimit, transparenca në procesin e projektimit, integrimi i objektivave të projektimit, përshtatshmëria e metodologjive të vlerësimit dhe bashkëpunimi ndërmjet ekipeve multidisiplinare të projektimit.

Për më tepër, është thelbësore të merren parasysh konceptet dhe mendimet për integrimin e rrezikut të ndryshimeve klimatike në politikat e mbrojtjes sociale, në mënyrë që të garantohet reagimi i tyre ndaj sfidave të lidhura me klimën.

Duke integruar këto karakteristika dhe zgjedhje të dizajnit, iniciativat e zhvillimit social të përgjegjshëm ndaj klimës mund të trajtojnë në mënyrë më efektive vështirësitë e paraqitura nga ndryshimet klimatike dhe të rrisin qëndrueshmërinë e komuniteteve dhe mjeteve të jetesës.

4.4. Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi

Matja e efektivitetit të programeve të integruara të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimit social është e ndërlikuar. Këto programe shpesh përfshijnë shumë sektorë, përfshijnë aktorë të ndryshëm dhe funksionojnë në shkallë të ndryshme. Për të trajtuar këtë kompleksitet, nevojiten analiza të fuqishme participative për të informuar hartimin e programit. Këto analiza identifikojnë treguesit bazë nëpër dimensione të ndryshme (p.sh. dimensionin socio-ekonomik, të jetesës dhe mjedisor) për të gjurmuar ndryshimet e cenueshmërisë dhe qëndrueshmërisë me kalimin e kohës. Është thelbësore të kategorizohen të dhënat sipas gjinisë dhe grupit përfitues për të kuptuar se si preken palët e ndryshme të interesit. Për më tepër, marrja në konsideratë e faktorëve socialë si perceptimet lokale të përshtatjes klimatike dhe vlerave kulturore në kornizat e monitorimit dhe vlerësimit është thelbësore. Qasjet me metoda të përziera ofrojnë një kuptim gjithëpërfshirës të ndryshimeve dhe arsyeve të tyre themelore.

5. Përfundim

Hartimi i strategjive gjithëpërfshirëse, të përgjegjshme ndaj klimës, që trajtojnë në mënyrë efektive humbjet dhe dëmtimet e mbetura, është një çështje sfiduese. Integrimi i rrezikut klimatik në kuadrin kombëtar të planifikimit strategjik është një masë thelbësore për të rritur kapacitetin e vendit për të mbrojtur popullsinë e tij më të prekshme nga ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike.

Kryesisht, vendimmarrja në fushën e planifikimit të qëndrueshëm duhet të kuptojë dhe të merr parasysh plotësisht rreziqet dhe pasiguritë që lidhen me ndryshimin e klimës. Në këtë kuadër, ne theksojmë rëndësinë e marrjes parasysh të pasojave të mundshme të ngjarjeve klimatike graduale, krahas rreziqeve që vijnë nga kushtet ekstreme klimatike. Megjithatë, ekziston një kuptim i kufizuar për ndikimin e vlerësimeve të rrezikut klimatik në politikën dhe planifikimin e PS, si dhe njohuritë dhe resurset e nevojshme për aktorët shtetërorë për të marrë vendime të informuara. Vlerësimet e rrezikut të klimës gjithashtu duhet të ofrojnë një kuptim gjithëpërfshirës të shkaqeve origjinale të cenueshmërisë, duke mundësuar ndërhyrje të synuara për të adresuar nevojat e grupeve më të rrezikuara, duke përfshirë të varfrit, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet e largëta.

Për më tepër, për të kapërcyer kufizimet e qasjeve ekzistuese për menaxhimin e rrezikut klimatik, është rëndësisë së posaçme të zhvillohen politika dhe praktika të PS që lehtësojnë adaptim transformues dhe në rritje ndaj ndryshimeve klimatike (ANK). Për të arritur këtë, është e domosdoshme të shqyrtohen ndikimet e qëndrueshme të programeve të ANK-së në politikën dhe praktikën socio-ekonomike, mjedisore, institucionale, kulturore dhe të infrastrukturës.

Propozohet që hartuesit e politikave të konsiderojnë migrimin dhe qasjen në mbrojtjen e shëndetit social si faktorë të rëndësishëm. Për më tepër, programet e mbrojtjes sociale (MS) paraqesin perspektiva për uljen e varfërisë dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe elasticitetit në zonat rurale të cënueshme dhe qendrat urbane me zgjerim të shpejtë. Duke analizuar këto fusha me interes, mund të kryhen kërkime për të përcaktuar nëse ndërhyrjet e politikave të gjelbra, ANK (Adaptimi ndaj Ndryshimeve Klimatike) dhe RRF (Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë) zvogëlojnë ose përforcojnë cënueshmërinë e atyre që kanë nevojë për mbrojtje sociale. Për më tepër, hulumtimi synon të identifikojë programet e mbrojtjes sociale të përgjegjshme ndaj klimës që mund të rrisin qëndrueshmërinë dhe elasticitetin afatgjatë.

Ky Udhëzues trajton gjithashtu çështjen thelbësore të ndërvarësisë së institucioneve dhe sektorëve kur bëhet fjalë për integrimin e rrezikut klimatik në kornizat kombëtare të MS. Marrja në konsideratë e mbrojtjes sociale të përgjegjshme ndaj klimës si pjesë e një strategjie gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut klimatik (MRK), në vend të qasjes së vetme për të rritur qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike, është thelbësore. Kur integrohet me iniciativa shtesë në sektorë siç janë infrastruktura, bujqësia dhe shëndetësia, MS mund të ofrojë avantazhe në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Është e rëndësishme të pranohet se ka sfida në integrimin e rrezikut të ndryshimeve klimatike në sektorin e MS. Zhvillimi i sistemeve kombëtare gjithëpërfshirëse të MS-së do të kërkojë disa dekada, së bashku me resurse të konsiderueshme institucionale, financiare dhe teknologjike për të përfshirë në mënyrë efektive një gamë të larmishme objektivash që synojnë rritjen e elasticitetit ndaj ndryshimeve klimatike. Sistemet e MS të vendit mund të përjetojnë mbingarkesë për shkak të limiteve të tyre integrale. Disa situata sugjerojnë se ofrimi i ndihmës humanitare mund të jetë një opsion më efikas dhe me kosto efektive në krahasim me ndërtimin e mbrojtjes sociale që i përgjigjet goditjeve klimatike.

Pavarësisht se janë rezistent ndaj klimës, programet e shpërndarjes së parave kanë aftësinë për të rritur elasticitetin ndaj rreziqeve klimatike. Për të lehtësuar shpërndarjen e resurseve dhe për të rritur aftësitë në nivel lokal, duhet bërë një analizë gjithëpërfshirëse për të eksploruar zhvillimin e mundshëm të politikave strategjike që mund të nxisin angazhimin e sektorit privat dhe të promovojnë iniciativat lokale për të adresuar ndryshimet klimatike.

Një aspekt tjetër thelbësor për t'u marrë parasysh është përfshirja e MS në objektivat kombëtar të zhvillimit dhe ndryshimit të klimës nëpërmjet sistemeve të mbikëqyrjes qeveritare. Monitorimi dhe vlerësimi i projekteve të mbrojtjes sociale të përgjegjshme ndaj klimës është një fushë kërkimore komplekse dhe kryesisht e pa eksploruar.

Shtojca A: Shembuj të programeve të Mbrojtjes Sociale që integrojnë menaxhimin e rrezikut klimatik

SHEMBUJ DHE IDE PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT:

1. Programet e drejta të tranzicionit:

- Zhvillimi i aftësive: përmirësimi i aftësive dhe rikualifikimi i punëtorëve në industritë karbon-intensive për punë në ekonominë e gjelbër (p.sh. energjia e rinovueshme, efikasiteti i energjisë, bujqësia e qëndrueshme). Zhvilloni programe trajnimi qëllimore për punëtorët në rajone si Manastiri, Negotina dhe Oslomeji, duke bërë tranzicion nga industritë me bazë qymyri në vende pune në energjinë e rinovueshme, efikasitetin energjetik, dhe bujqësinë e qëndrueshme. Jepini prioritet përfshirjes së grave dhe grupeve të marginalizuara të prekura në mënyrë jo proporcionale nga tranzicioni.
- Mbështetja e të ardhurave: Ofroni ndihmë të përkohshme financiare për punëtorët e prekur nga tranzicioni në punët e gjelbra, duke siguruar që ata të kenë një rrjet sigurie gjatë tranzicionit në punët e gjelbra.
- Rrjetat e sigurisë sociale: Zgjeroni programet ekzistuese të mbrojtjes sociale (p.sh. përfitimet e papunësisë, pensionet) për të siguruar që popullsia e cënueshme të mos lihet pas gjatë tranzicionit.
- Projektet e bazuara në komunitet: Investoni në projekte të infrastrukturës së gjelbër (p.sh. mikro-rrjetet e energjisë së rinovueshme/diellore, menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave) që krijojnë vende pune lokale në qendrat urbane dhe reduktojnë emetimet.

2. Bujqësia e mençur klimatike:

- Stimulime financiare: Ofroni subvencione ose kredi me interes të ulët për fermerët në rajone si Rajoni Lindor, Rajoni Juglindor, Rajoni i Vardarit dhe Pellagonia për përvetësimin e praktikave të mençura klimatike, siç janë kulturat bujqësore rezistente ndaj thatësirës dhe sistemet e ujitjes që kursejnë ujin.
- Asistencë teknike: Ofroni fermerëve trajnime dhe shërbime këshillëdhënëse mbi praktikat bujqësore rezistente ndaj klimës për të ndihmuar fermerët të përshtaten me ndryshimet e motit.
- Sigurimi i rrezikut: Zhvilloni skema sigurimesh me indeks të motit për të mbrojtur fermerët nga humbjet e lidhura me klimën.
- Qasja në treg: Mbështetni iniciativat që lidhin fermerët me tregjet për produktet e tyre miqësore me klimën, duke promovuar bujqësi të qëndrueshme dhe duke përmirësuar stabilitetin e të ardhurave.

3. Zhvillimi Urban i Gjellbër:

- Subvencione për transport publik: Inkurajoni përdorimin e transportit publik në qytete si Shkupi duke ofruar subvencione për kartela për autobusë dhe duke investuar në programe për shkëmbim të biçikletave dhe infrastrukturë për automjete elektrike.
- Rinovimet e ndërtesave: Ofroni stimulime për pronarët e shtëpive dhe bizneset për të përmirësuar efikasitetin energjetik në ndërtesa, duke reduktuar konsumin e energjisë dhe emetimet.
- Hapësirat e gjelbra urbane: Investoni në zhvillimin e parqeve, kulmeve të gjelbra dhe kopshteve urbane për të rritur biodiversitetin, për të zvogëluar efektin e ishullit të nxehtësisë urbane dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit.
- Menaxhimi i mbeturinave: Përmirësoni sistemet e menaxhimit të mbeturinave për të promovuar riciklimin dhe kompostimin, duke reduktuar emetimet e mbetjeve dhe duke promovuar një ekonomi qarkulluese.

4. Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë bazuar në komunitet:

- Sistemet e paralajmërimit të hershëm: Zbatoni sisteme të paralajmërimit të hershëm për përmytjet dhe thatësitat, veçanërisht në zonat e rrezikuara nga përmytjet siç është pellgu i lumit Vardar.
- Planet e evakuimit dhe strehimoret: Zhvilloni plane gjithëpërfshirëse evakuimi dhe ndërtoni strehimore rezistente ndaj klimës për komunitetet në zonat me rrezik të lartë.
- Restaurimi i infrastrukturës natyrore: Përkrahni projektet që përtërijnë ekosistemet si pyjet dhe ligatinat, të cilat ofrojnë barriera natyrore kundër ndikimeve klimatike.
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi për klimën: Kryeni programe dhe fushata edukative për komunitetin për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet klimatike dhe strategjitë adaptuese.

Mbani mend të:

- Përshtatni strategjitë e zbutjes me kontekstin dhe nevojat specifike të popullatës suaj të synuar.
- Sigurohuni që përfshirja sociale dhe barazia janë kryesore për hartimin dhe zbatimin e programeve të zbutjes.
- Promovoni bashkëpunimin ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat për shfrytëzimin e resurseve dhe ekspertizës.
- Monitoroni dhe vlerësoni efektivitetin e strategjive të zbutjes dhe përshtatni ato sipas nevojës.
- Duke integruar këto strategji zbutjeje në programet e mbrojtjes sociale, ne mund të krijojmë një të ardhme më të drejtë dhe më të qëndrueshme për të gjithë, duke adresuar njëkohësisht sfidat e ndryshimeve klimatike.

Duke hartuar këto strategji zbutëse në kontekstin specifik të Maqedonisë së Veriut dhe duke siguruar përfshirje sociale dhe barazi, MPPS mund të trajtojë në mënyrë efektive sfidat e ndryshimeve klimatike duke promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e popullatave të cënueshme. Bashkëpunimi ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile dhe sektorit privat është thelbësor

për shfrytëzimin e burimeve dhe ekspertizës, dhe monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm do të ndihmojë në përshtatjen e strategjive sipas nevojës.

PLANIFIKIMI STRATEGJIK DHE FINANCIAR AFATGJATË I KROACISË

Kroacia ka zhvilluar një Strategji për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike deri në vitin 2040¹², me një plan veprimi përkatës (deri në vitin 2040, me disa konsiderata afatgjata deri në vitin 2070.

Strategjia jep vizionin dhe udhëzimet për zhvillimin e masave të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike, ndërsa Plani i Veprimit identifikon masat prioritare për periudha pesëvjeçare.

Qeveria aplikoi një qasje me shumë kritere për përzgjedhjen e masave prioritare dhe përfshiu aktorë të shumtë nga sektorët përkatës. Nga 155 aktivitetet e propozuara, 81 u zgjodhën për zbatim për menaxhimin e burimeve ujore dhe detare, peshkimin, bujqësinë, pylltarinë, bio-diversitetin, energjinë, turizmin, shëndetin, planifikimin dhe menaxhimin hapësinor të zonës bregdetare, menaxhimin e rrezikut dhe masat mbi-sektoriale. U miratua një sistem treguesish për të monitoruar zbatimin dhe efektivitetin e masave për reduktimin e cenueshmërisë dhe forcimin e rezistencës së sistemeve sociale dhe natyrore. Qeveria caktoi Komisionin Koordinues Ndër-sektorial për politikën e ndryshimeve klimatike, zbutjen dhe masat e përshtatjes për të kontrolluar zbatimin e Planit të Veprimit, për të shqyrtuar raportet dhe për të propozuar masa për heqjen e pengesave dhe përmirësimin e zbatimit. Në afat të shkurtër, Strategjia e Përshtatjes vlerësohet të kushtojë 3.6 miliardë euro (99 % nga fondet e BE-së).

Çdo vend i Evropës Qendrore dhe Lindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore (EQLKAQ) mund të zbatojë një qasje të tillë gjithëpërfshirëse, e cila përmban:

- një horizont planifikimi afatgjatë me piketa 5-vjeçare;
- një gamë e gjerë opsionesh për aktivitete që duhet dhënë përparësi;
- sektorë të ndryshëm që përfaqësojnë sfida të ndryshme socio-ekonomike;
- shumë palë të interesuara që vendosin prioritetet dhe ndihmojnë në sigurimin e përfaqësimit të grupeve të ndryshme shoqërore;
- një organ koordinues ndër-sektorial që lehtëson zbatimin; dhe
- burimet e financimit të identifikuar dhe të vlerësuara saktë.

Detaje të mëtejshme mund të merren në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kroacisë dhe Strategjisë për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike deri në vitin 2040, me synimin deri vitin 2070, në të dy versionet kroate dhe angleze:

Versioni kroat: https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2020_04_46_921.html

Versioni në anglisht: https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2020_04_46_921.html

Ndërkohë që Ministria e Ekonomisë dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm udhëheq politikën dhe strategjinë kombëtare për ndryshimet klimatike, disa ministri dhe institucione të tjera luajnë role vendimtare në integrimin e dimensionit social. Në mënyrë të veçantë, Ministria e Punës dhe

¹² Burimi: <https://mingor.gov.hr/UserDocsImages/KLIMA/Climate%20change%20adaptation%20strategy.pdf>

Politikës Sociale (MPPS) mban përgjegjësi të konsiderueshme për adresimin e ndikimeve sociale të ndryshimeve klimatike dhe sigurimin e programeve të mbrojtjes sociale të përgjegjshme ndaj klimës.

Komisioni Koordinues Ndër-sektorial për Politikën e ndryshimeve klimatike, masat zbutëse dhe adaptuese përfshin përfaqësues nga ministri dhe aktorë të ndryshëm, përfshirë MPPS-në. Kjo siguron që konsideratat sociale të integrohen në planifikimin dhe zbatimin e planeve dhe strategjive të veprimit për klimën.

Përveç kësaj, MPPS ka publikuar strategjinë e saj për "Zhvillimin e Gjellbër Social 2021-2030", e cila përshkruan veprimet e saj për të adresuar ndikimet sociale të ndryshimeve klimatike dhe për të promovuar një tranzicion të drejtë drejt një ekonomie të gjellbër.

Më shumë informacion rreth iniciativave të MPPS-së në lidhje me ndryshimet klimatike dhe mbrojtjen sociale mund të gjeni në faqen e tyre të internetit: <https://mrosp.gov.hr/>

PROJEKTET E FONDIT TË GJELBËR TË KLIMËS (FGJK) NË AZINË QENDRORE

Kur lidhim projektet e Fondit të Gjellbër të Klimës (FGJK) në Azinë Qendrore me qëllimin e përgjithshëm të udhëzuesit, dhe i bëjmë ato relevante për stafin e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS) që harton dhe zbaton programet e mbrojtjes sociale (MS), ne mund të marrim në konsideratë pikat në vijim:

Stafi i MPPS-së mund të përfitojë nga të kuptuarit e projekteve të FGJK në Azinë Qendrore, pasi këto projekte sigurojnë njohuri të vlefshme për zhvillimin e qëndrueshmërisë ndaj klimës. Duke studiuar sukseset dhe sfidat e këtyre projekteve, stafi mund të zbatojë mësimet përkatëse për hartimin dhe zbatimin e programeve të MS-së në Maqedoninë e Veriut.

Projektet e FGJK-së shpesh fokusohen në ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj klimës, e cila është një aspekt vendimtar për programet e MS-së. Stafi i MPPS-së duhet të sigurojë që programet e MS-së në Maqedoninë e Veriut të përfshijnë vlerësime të rrezikut klimatik dhe masa adaptuese për mbrojtjen e popullatave të cënueshme nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Kuptimi i projekteve të FGJK-së mund të ndihmojë stafin e MPPS-së të identifikojë mundësitë për qasje tek financimet ndërkombëtare të klimës për të mbështetur programet e MS-së. Duke përafuar programet e PS-së me objektivat e qëndrueshmërisë klimatike, MPPS mund të rrisë përshtatshmërinë e këtyre programeve për financimin e FGJK-së ose mekanizma të tjerë financiarë ndërkombëtarë.

Projektet FGJK-së shpesh përdorin qasje inovative për të adresuar ndryshimet klimatike, siç janë shfrytëzimi i teknologjisë, promovimi i bujqësisë së qëndrueshme dhe përmirësimi i menaxhimit të ujit. Stafi i MPPS-së mund të eksplorojë se si këto qasje novatore mund të përshtaten dhe integrohen në programet e MS-së për të arritur përfitime të shumta, duke përfshirë përshtatjen klimatike, zhvillimin ekonomik dhe mbrojtjen sociale.

Zbatimi i projekteve të FGJK-së përfshin bashkëpunimin ndërmjet qeverive, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe sektorit privat. Stafi i MPPS-së mund ta përdorë këtë si një

model për ndërtimin e partneriteteve të forta për të rritur efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e programeve të MS-së.

Projektet e FGJK-së në Azinë Qendrore janë në përputhje me prioritetet e zhvillimit kombëtar dhe rajonal. Stafi i MPPS-së duhet të sigurojë që programet e MS-së të jenë koherente me strategjitë dhe politikat kombëtare për ndryshimet klimatike, duke kontribuar në qëllimet e përgjithshme të zhvillimit të qëndrueshëm dhe qëndrueshmërisë klimatike.

Stafi i MPPS-së mund të angazhohet në nisma për shkëmbim të njohurive dhe ngritjen e kapaciteteve me homologët në Azinë Qendrore për të shkëmbyer praktikat dhe përvojat më të mira në integrimin e menaxhimit të rrezikut klimatik në programet e MS-së.

Në mars 2018, FGJK miratoi një projekt në shkallë të gjerë, »Ndërtimi i qëndrueshmërisë klimatike të komuniteteve të cënueshme dhe të pasigurta ushqimore përmes forcimit të kapaciteteve dhe diversifikimit të mjeteve për jetesë në rajonet malore të Taxhikistanit«.

Faqja e projektit të Fondit të Gjellbër të Klimës: <https://www.greenclimate.fund/project/fp067>

Ky projekt zbatohet nga Programi Botëror i Ushqimit (PBU) në bashkëpunim me Komitetin për Mbrojtjen e Mjedisit (KMM) të Taxhikistanit. Ai synon të rrisë qëndrueshmërinë klimatike të komuniteteve të cënueshme në Luginën e Rasht, Khatlon dhe Rajonin Autonom të Gorno-Badakhshan (RAGB) me:

- Forcimin e kapaciteteve të komuniteteve për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike përmes trajnimeve dhe ndërgjegjësimin.
- Diversifikimi i mjeteve të jetesës për të reduktuar varësinë nga aktivitetet e ndjeshme ndaj klimës.
- Përmirësimi i menaxhimit të ujit dhe praktikave bujqësore.

Nga projekti pritet të përfitojnë mbi 120,000 njerëz, duke përfshirë fermerë, blegtorë, gra dhe fëmijë.

Komunitetet malore kanë kapacitete shumë të dobëta përshtatëse për të përballuar ndikimet e rënda të rritjes së temperaturës dhe ndryshueshmërisë së reshjeve dhe fatkeqësive natyrore të përsëritura, veçanërisht thatësitat dhe përmbytjet. Ky projekt 10 milionë dollarësh do të prezantojë masat për përshtatje për të adresuar efektet e ndryshimeve klimatike që ulin rendimentet bujqësore, rrisin çmimet e ushqimeve dhe reduktojnë të ardhurat në komunitetet rurale më të cënueshme. Një nismë e përbashkët Taxhik-Uzbeke u miratua në qershor 2016: FGJK siguroi 68.8 milionë USD për një program adaptimi dhe zbutjeje klimatike për komunitetet më të cënueshme në pellgun e Detit Aral. U siguruan kredi dhe grante të ndryshme të fokusuara në masat rezistente ndaj klimës për zonat prioritare, duke përfshirë popullsinë më të varfër në zonat e rrezikuara dhe grupet e marginalizuara, si gratë. Vendet e EQLKAQ me të ardhura të ulëta dhe me përvojë të kufizuar në iniciativat e ndërtimit të qëndrueshmërisë mund të mbështeten mbi këtë program për të zhvilluar dhe zbatuar projekte të financuara nga FGJK. I gjithë dokumentacioni i projektit është i vënë në dispozicion në portalin e FGJK-së dhe mund të përdoret si model për projekte të reja. Programi për Adaptim dhe Zbutje Klimatike për Pellgun e Detit Aral (PAZKPDA), është një nismë e përbashkët nga Taxhikistani, Uzbekistani dhe Banka Botërore e financiar nga Fondi i Gjellbër i Klimës (FGJK).

Këtu janë disa faqe interneti përkatëse:

Faqja e projektit të Fondit të Gjelbër të Klimës: <https://www.greenclimate.fund/project/fp014>

Faqja e projektit të Bankës Botërore: <https://projects.worldbank.org/en/projects/P151363>

Informacion shtesë mbi PAZKPDA: <https://carececo.org/en/main/activity/projects/>

FINANCAT ADAPTUESE TË HUNGARISË

Hungaria ka shfrytëzuar me shumë sukses resurse të ndryshme për të financuar aktivitetet e saj adaptuese. Plani i Ri i Zhvillimit të Hungarisë përfshin politika dhe programe operacionale që synojnë mbrojtjen e mjedisit dhe klimës dhe zhvillimin bujqësor e rural. Mbështetja e përgjithshme e adaptimit për programet hungareze nga viti 2014 deri në vitin 2020 kushtoi 893 milionë euro, kryesisht të financuara nga BE-ja. Prioritetet përfshijnë menaxhimin e ujit, dhe mbrojtjen e ujit të pijshëm dhe cilësisë së ajrit; zhvillimin e biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër; dhe masat specifike në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e rrezikut. Hungaria përdor instrumente të shumta për të mbledhur fonde për financimin e klimës, siç janë Strategjia e BE-së për Danubin, Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal, Instrumenti Evropian i Fqinjësisë dhe Mekanizmat Financiar Norvegjez. Hungaria gjithashtu merr pjesë në iniciativat rajonale për rritjen e qëndrueshmërisë dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, për shembull duke nisur Fondin e Trustit Rajonal Ballkanik për të zbatuar Kontributet e Përcaktuara Kombëtare nga vendet e Ballkanit, kontributet financiare në FGJK dhe fonde të tjera dypalëshe dhe shumëpalëshe (afërsisht 30 milion euro në vit midis 2016 dhe 2018). Suksesi mbresëlënës i Hungarisë në tërheqjen e fondeve masive për zhvillimin, përshtatjen dhe për aktivitetet e qëndrueshmërisë vjen nga aftësia e saj për të propozuar një spektër të gjerë projektesh dhe programesh për donatorët¹³.

Më poshtë janë disa faqe interneti rreth suksesit të Hungarisë në tërheqjen e fondeve të konsiderueshme për zhvillimin, përshtatjen dhe aktivitetet e qëndrueshmërisë që mund t'i atribuohen disa faktorëve:

- <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/ec7d67f1-en/1/3/1/>
- <https://commission.europa.eu/business-economy-euro/economic-recovery/>

Hungaria ka qenë e suksesshme në propozimin e një spektri të gjerë projektesh dhe programesh që kujdesen për sektorë të ndryshëm, duke përfshirë mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e infrastrukturës, efikasitetin e energjisë dhe përshtatjen klimatike. Kjo llojllojshmëri siguron më shumë gjasa të përputhet me interesat dhe prioritetet e donatorëve të ndryshëm. Vendi ka krijuar institucione dhe mekanizma të fuqishëm për të menaxhuar dhe zbatuar në mënyrë efektive këto projekte. Kjo përfshin struktura të qarta qeverisëse, procese transparente të prokurimit dhe sisteme efektive të menaxhimit të projekteve, të cilat rrisin besimin e donatorëve.

¹³ Burimi: <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/ec7d67f1-en/1/3/1/index.html?itemId=/content/publication> dhe <https://commission.europa.eu/business-economy-euro/economic-recovery/>

Hungaria ka kërkuar në mënyrë aktive partneritete me organizata ndërkombëtare, vende të tjera dhe subjekte të sektorit privat. Këto partneritete ndihmojnë në shfrytëzimin e resurseve, ekspertizës dhe teknologjive shtesë për projektet e saj.

Si anëtare e Bashkimit Evropian, Hungaria ka qasje në fondet dhe mekanizmat e financimit të ndryshëm të BE-së, si Fondi i Kohezionit dhe Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal, të cilët mbështesin aktivitetet për zhvillim dhe qëndrueshmëri. Vendi ishte në gjendje të iu komunikojë donatorëve të mundshëm në mënyrë efektive rëndësinë dhe ndikimin e mundshëm të projekteve të veta. Kjo përfshin prezantimin e historive të suksesit, demonstrimin e përafrimit të projekteve me objektivat global të qëndrueshmërisë dhe nxjerrjen në pah të përfitimeve si për Hungarinë ashtu edhe për rajonin më të gjerë.

Gjithashtu, ata kanë treguar një gatishmëri për t'iu përshtatur rrethanave në ndryshim dhe për të inkorporuar qasje inovative në projektet e saj. Kjo përfshin përqafimin e teknologjive të reja, angazhimin në partneritete publiko-private dhe zhvillimin e projekteve që adresojnë sfidat e reja si ndryshimi i klimës.

Në përgjithësi, aftësia e Hungarisë për të propozuar një gamë të gjerë projektesh të mirë-projektuara dhe të harmonizuara në mënyrë strategjike, e kombinuar me kuadrin institucional të saj të fortë dhe me partneritetet strategjike, ka qenë çelësi i suksesit të saj në tërheqjen e fondeve të konsiderueshme për aktivitetet e zhvillimit dhe qëndrueshmërisë. Vendet e tjera të EQLKAQ mund të përfitojnë nga shembulli i Hungarisë dhe të krijojnë portofol të propozim projekteve për donatorët e mundshëm në vend që të realizojnë projekte të shumta të vogla që kërkojnë po aq dokumente.

REPUBLIKA ÇEKE: OPSIONE PËR FINANCIM TË ADAPTIMIT DUKE PËRDORUR TË ARDHURAT NGA SKEMAT E TREGTIMIT TË EMETIMEVE TË BE-së (BE STE)

Rregullorja 27 e BE-së për karbonin detyron Shtetet Anëtare të përdorin të paktën 50% e të ardhurave të krijuara nga ankandet STE të BE-së për qëllime të caktuara paraprakisht – kryesisht duke përfshirë reduktimin e GS-së dhe përshtatjen ndaj efekteve negative nga ndryshimet klimatike. Republika Çeke parashikon të fitojë 1 miliardë euro deri në vitin 2020 duke nxjerrë në ankand kompensimet e saj për GS-në, dhe shumë më tepër midis viteve 2021 dhe 2030. Përderisa shumica e këtyre të ardhurave do të investohen në efikasitetin energjetik dhe burimet e rinovueshme të energjisë, prioritetet e tjera kombëtare përfshijnë bujqësinë dhe pylltarinë dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe menaxhimin e mbeturinave. Vendimi i BE-së për Ndarje të Përpjekjeve iu mundëson vendeve më shumë fleksibilitet në transferimin një numri të kufizuar kredish nga sektori i përdorimit të tokës – gjë që mund të stimulojë masat e qëndrueshmërisë në bujqësi dhe pylltari midis vitit 2021 dhe 2030. Kreditë e karbonit të fituara në këtë sektor mund t'u mundësojnë komuniteteve rurale financa shtesë për adaptim. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së në rajonin e EQLKAQ, ashtu si Kazakistani dhe vendet e tjera me STE ose mekanizma të tjerë për kosto të karbonit, mund të aplikojnë instrumente siç janë të ardhurat nga kredia e karbonit për të financuar problemet lidhur me qëndrueshmërinë dhe adaptimin, mundësisht ato të përqendruara në sfidat dhe nevojat sociale.